



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 21/2023 regjistër (JR)
Datë 23.05.2023

Nr. 29 i vendimit
Datë 10.04.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 10.04.2025, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Rexhina Merlika, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 635, datë 13.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit¹ një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar krijimin e pasurive*; (iii) *ka mosdeklarime të pasurisë në vite*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në vijim të konstatimit fillestar për përshtatshmërinë në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e Grupit të Punës², duke referuar informacionet e ardhura nga institucionet e verifikimit në kohështirje para periudhës së rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka gjykuar që, për rastin në fjalë, konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit.

2.3. KLGj-ja, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Rexhina Merlika³.

3. Komisioni, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, nga vlerësimi i kriterit të pasurisë sipas paragrafit 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, dhe për këto arsye vendosi:

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 25.11.2019, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të pasurisë së subjektit Rexhina Merlika, me funksion Gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.

² Shih raportin e dërguar nga DSIK-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 29.08.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. {***}, datë 19.09.2022.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 07.12.2021, “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika”.

“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

4. Vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për kriterin e pasurisë.

- Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsyet e përmendura në këtë vendim në kriterin “vlerësim i pasurisë”.

- Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të paplotë dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

- Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasuritë, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

- Duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 1 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon se: “Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë dhe burimin e krijimit.

- Pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

- Pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon se, nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë.

- Subjekti nuk gjendet në kushtet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, subjekti gjendet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

- Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

- Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika nuk ka arritur nivel të mjaftueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

II. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit të Komisionit nr. 635, datë 13.03.2023, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Rexhina Merlika. Në tërësinë e tij, ankimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit është në përputhje me prapësimet e tij për rezultatet e hetimit administrativ, si dhe parashtrimet në ankim. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesa me natyrë procedurale, si dhe ka ngritur pretendime lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, në funksion të kërimit përfundimtar për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë.
6. Duke e konsideruar vendimin e Komisionit të pabazuar në ligj dhe në prova, subjekti i rivlerësimit paraqet këto shkaqe procedurale në ankim: (i) Në përgjigje të rezultateve të hetimit, me kërkesën e datës 06.03.2023, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit të thirren në cilësinë e dëshmitarëve huadhënësit, por kjo kërkesë i është refuzuar nga Komisioni pa e arsyetuar atë, sipas parashikimeve të pikës 9, të nenit 49⁴, të ligjit nr. 84/2016; (ii) Subjekti ka kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e disa provave të reja shkresore, në funksion të provueshmërisë së mundësisë financiare të huadhënësit P. H., për t'i dhënë bashkëshortit të subjektit huan në shumat e deklaruara.
7. Shkaqet e ankimit lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes, që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur, paraqiten si më poshtë:

7.1. Për pasurinë “apartament banimi me sip. 105.13 m²” dhe “garazh me sip. 24.41 m²”, rruga “{***}”, nr. {***}, Tiranë:

(i) Lidhur me pagesën e kështit të parë, në shumën 62.000 euro, në datën 17.10.2008. Subjekti i rivlerësimit, duke iu referuar të dhënave të “Raportit financiar të ekspertit kontabël, datë 03.03.2023”, depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, pretendon se analiza e treguesve financiarë, bazuar në të njëjtin dokumentacion të administruar gjatë hetimit administrativ, por sipas një metodologjie tjetër nga ajo e përdorur nga Komisioni, vërteton dhe konfirmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi dhe burime financiare të ligjshme për mbulimin e pagesës së kështit të parë, në shumën 62.000 euro.

(ii) Subjekti i rivlerësimit, në këtë shkak ankimor, kundërshton konstatimet e Komisionit sa i përket: (i) pamundësisë financiare të prindërve të bashkëshortit për të kursyer dhe krijuar gjendjen e likuiditetit në shumën 2.225.107 lekë për periudhën 1989 – 2002, nga i cili pretendon se i është dhënë shuma 1.700.000 lekë, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e depozitës në vlerën 35.000 euro, në vitin 2007; (ii) pamundësisë financiare për krijimin e shtesës 300.000 lekë në kursime *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme për vitin e mbyllur 2004; (iii) rezultateve të analizës financiare të Komisionit, për periudhën 2004 – 2006, si dhe (iv) mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e depozitës bankare prej 35.000 euro, më datë 17.01.2007, nëpërmjet së cilës është bërë likuidimi i kështit të parë të blerjes së apartamentit.

(iii) Lidhur me pagesën e kështit të dytë, në shumën 30.000 euro, në datën 20.03.2009, subjekti i

⁴ “Refuzimi i kërkesës për marrjen e provës bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke argumentuar shkaqet e refuzimit”.

rivlerësimit pretendon se ka provuar që personi tjetër i lidhur, A. L., ka pasur mundësi financiare për dhënien e huas në shumën 20.000 euro, në janar të vitit 2009, hua e cila ka shërbyer si burim për shlyerjen e kështit të dytë të blerjes së kësaj pasurie.

(iv) *Lidhur me pagesën e kështit të tretë, në shumën 30.000 euro, në datën 02.07.2010*, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka provuar që personi tjetër i lidhur, P. H., ka pasur mundësi financiare për dhënien e huas në shumën 5.000.000 lekë, në korrik të vitit 2010, hua e cila ka shërbyer si burim për shlyerjen e kështit të dytë të blerjes së kësaj pasurie.

(v) *Lidhur me pagesën e kështit të fundit, në shumën 25.391 euro, në datën 30.06.2011*, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka provuar që personi tjetër i lidhur, P. SH., ka pasur mundësi financiare për dhënien e huas në shumën 15.000 euro, në mars të vitit 2011, hua e cila ka shërbyer si burim për shlyerjen e kështit të fundit të blerjes së kësaj pasurie.

Subjekti pretendon se dokumentacioni i vënë në dispozicion për të vërtetuar mundësinë e huadhënësve që, me të ardhura të ligjshme, të japin shumat e deklaruara, ka qenë i mjaftueshëm për të provuar të kundërtën e barrës së provës. Komisioni, megjithëse ka konstatuar që huadhënësit kanë pasur lëvizje të konsiderueshme në bankë dhe shumat e depozituara kalojnë shumën e dhënë hua, nuk e ka konsideruar këtë fakt si kriter vlerësimi.

7.2. *Lidhur me analizën financiare për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016*, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimet se: (a) “*Raporti financiar i ekspertit kontabël*” nxjerr në pah një rezultat të ndryshëm nga ai Komisionit. (b) Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me deklarimin e gjendjeve *cash* (shtimi/pakësimi dhe destinacioni i tyre) nga vetë ajo dhe personi i lidhur, në deklaratat periodike vjetore, dhe konstatimet mbi mospërputhjet e deklarimeve të kryera nga subjekti në ILDKPKI, gjatë hetimit administrativ, në Komision, lidhur me këto kursime dhe shlyerjet e huave. (c) Subjekti i rivlerësimit kundërshton balancat negative të rezultuara nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, për periudhën e rivlerësimit.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

(a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë (në vijim “Kushtetuta”) dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë (në vijim “Aneksit të Kushtetutës”), si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

(b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

(c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1⁵ e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 635, datë 13.03.2023, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, më datë 10.04.2025.
11. Trupi gjykues shqyrtoi fillimisht pretendimet dhe kërkesat procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, konkretisht:

11.1. Në shkakun ankimor lidhur me provueshmërinë e mundësisë financiare të huadhënësve A. L. dhe P. SH., për të dhënë huat e deklaruar, respektivisht në shumën 20.000 euro, në janar të vitit 2009 dhe 15.000 euro, në mars të vitit 2011, subjekti ngre pretendimin se, me kërkesën e datës 06.03.2023, në përgjigje të rezultateve të hetimit, i ka kërkuar Komisionit edhe thirrjen në cilësinë e dëshmitarëve të këtyre huadhënësve, por kjo kërkesë është konsideruar “e panevojshme” nga Komisioni⁶. Subjekti pretendon se refuzimi i Komisionit nuk ishte kategorik, pasi në këtë rast nuk lejohej prova me dëshmitarë, por përkundrazi është shprehur se nuk është e nevojshme. Kjo sjellje e Komisionit për subjektin nuk përbën arsyetim për refuzimin e kësaj kërkeje, sipas parashikimeve të pikës 9, të nenit 49⁷ të ligjit nr. 84/2016.

11.2. Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, vëren se subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës 06.03.2023, të protokolluar në Komision me nr. {***} prot., ka kërkuar të thirren në cilësinë e dëshmitarit huadhënësit A. L. dhe P. SH., për t’u pyetur lidhur me ekzistencën e marrëdhënies së huas, mënyrën dhe kohën e shlyerjes së saj, si dhe burimet e të ardhurave për krijimin e shumave të dhëna. Nga aktet në fashikull rezulton se Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 07.03.2023, “Për refuzimin e kërkesave të subjektit të rivlerësimit, znj. Rexhina Merlika”, ka vlerësuar se ajo nuk pranohet, pasi në përputhje me shkronjën “a”, pika 6, neni 49, të ligjit nr. 84/2016, marrja e kësaj prove është e panevojshme. Në vijim, Komisioni, me email-in e datës 07.03.2023, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë vendimarrje.

11.3. Trupi gjykues, në konsideratë të parimeve të procesit të rregullt ligjor,⁸ në rastin konkret

⁵ “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; nenet 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

⁶ Referohu email-it të datës 07.03.2023.

⁷ “Refuzimi i kërkesës për marrjen e provës bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke argumentuar shkaqet e refuzimit”.

⁸ Neni 6 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”) nuk garanton qartazi të drejtën për të thirrur dëshmitarë dhe pranueshmëria e dëshmimeve, në parim, është kompetencë e së drejtës së brendshme. Në jurisprudencën e saj, në çështjen Wierzbicki k. Polonisë, 2002, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur: “[...]. Gjykata është e kënaqur që gjykatat e brendshme shqyrtuan kërkesat e aplikantit për të thirrur dëshmitarë dhe dhanë arsye të

vlerëson se, për shkak të rrethanave në të cilat pretendohet se ndodhen këta dëshmitarë (*në cilësinë e huadhënësve dhe personave që njihen prej vitesh*), dëshmia e tyre nuk do të sillte ndonjë ndryshim për efekt të këtij procesi, në drejtim të provueshmërisë së mundësisë së tyre financiare, që me burime të ligjshme të japin huat në vlerat e deklaruara. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të thirren si dëshmitarë huadhënësit, për të dëshmuar mbi ato rrethana, për të cilat është shprehur gjatë hetimit administrativ dhe nuk ka argumentuar mbi risitë që do të sillte në shqyrtimin e çështjes, dëshmia e tyre. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se, edhe në konsideratë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi mungesën e zgjeruar të arsytimit të vendimmarrjes së Komisionit për refuzimin e kërkesës për thirrjen e dëshmitarëve, në rastin konkret, nuk konstatohet se kjo vendimarrje ka cenuar procesin e rregullt. Komisioni e ka vlerësuar kërkesën e subjektit dhe e ka refuzuar atë, në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës, duke e vlerësuar *të panevojshme*, vlerësim ky që gjen parashikim në shkronjën “a”, pika 6 e nenit 49, të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për këtë çështje vlerësohet nga trupi gjykues, i pabazuar.

11.4. Në shkaqet e ankimit lidhur me provueshmërinë e mundësisë financiare të huadhënësit P. H., për t’i dhënë bashkëshortit huan e deklaruar në shumën 5.000.000 lekë, në korrik të vitit 2010, subjekti ka kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e disa provave të reja shpresore, konkretisht: (i) Të llogarisë dyemërore, C. S. H. ose P. SH. H., në Bankën e Kursimeve, Dega Krujë, në monedhën *lekë*, më datë 06.07.1994, e cila ka vijuar deri më 07.09.2005, dhe të llogarisë së depozitës nr. {***}, P. SH. H., në Raiffeisen Bank, në monedhën *lekë*, për periudhën 07.09.2005 deri më 16.09.2022, me balancë deri në momentin e transferimit në ABI Bank ShA, në shumën 150.000.000 lekë. (ii) Të llogarisë së depozitës nr. {***}, P. SH. H., në Credins Bank ShA, në monedhën *dollarë amerikanë*, për periudhën 31.03.2004 deri më 03.04.2013, e cila në momentin e transferimit në USA, ka pasur tepricë në shumën 26.937,10 USD. (iii) Të llogarisë rrjedhëse nr. {***}, P. SH. H., në Raiffeisen Bank ShA, në monedhën *lekë*, për periudhën 16.06.2010 – 16.09.2022, me balancë në momentin e transferimit në ABI Bank ShA, në shumën 22.224.292,77 lekë. (iv) Të llogarisë së depozitës nr. {***}, në emër të P. SH. H., në Raiffeisen Bank, në monedhën *dollarë amerikanë*, për periudhën 18.05.2010 – 16.09.2022, me balancë në momentin e transferimit në ABI Bank ShA, në shumën 149.488,78 USD. (v) Deklaratë për burimin e pasurisë, datë 16.09.2022, pranë ABI Bank ShA, Tiranë, ku janë deklaruar burimet e krijimit të të ardhurave në *lekë* dhe *dollarë amerikanë*, në momentin e çeljes së llogarive, balancat e të cilave janë transferuar më pas në shumat e cituara më lart.

11.5. Trupi gjykues, në përgjigje të pretendimeve të ngritura në ankim, shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja dhe riçeljen e hetimit, bazuar në parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, konkretisht në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, në të cilin parashikohet: “*Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*”, si dhe në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në të

hollësishme për refuzimet e tyre, të cilat, sipas Gjykatës nuk ishin të ndotura nga arbitrariteti. Për këto arsye, refuzimi për të marrë provat e propozuara nga kërkuuesi nuk përbën një kufizim joproporcional, të aftësisë së tij për të paraqitur argumente në mbështetje të rastit të tij, gjatë gjyqimit. Sa më sipër, nuk ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës”. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 38/2010, është shprehur: “Nëse gjykatat e zakonshme vërejnë se dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, ato mund ta refuzojnë kërkesën për marrjen në pyetje të dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë. Kjo nuk bëhet për të siguruar vetëm respektimin e barazisë së armëve, por dhe të parimit të kontradiktoritetit të gjyqimit ose të shqyrtimit të provave”.

cilin parashikohet: “Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Posaçëm i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) marrja e provës duket se është e panevojshme; (b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] (d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili, edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”.

Në verifikim të parashikimeve ligjore, në rastin konkret vlerësohet se aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, nuk mbështeten mbi fakte që provojnë mospasjen mundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision, siç kërkon zbatimi i nenit 47, të ligjit nr. 49/2012. Trupi gjykues, për sa administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, vlerëson se, edhe në plotësim të këtyre kriterëve, nuk konsiderohen të nevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi këto akte, në një vështrim *prima facie*, nuk ndryshojnë rrethanat e konstatuara mbi mundësinë financiare të huadhënësve dhe nuk ndikojnë në marrjen e vendimit në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

11.6. Në përputhje me nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, para seancës së shqyrtimit të çështjes, subjekti i rivlerësimit, më datë 02.04.2025, paraqiti në Kolegj parashtrime me shkrim, duke kërkuar, sikurse dhe në shkaqet e ankimit, riçeljen e hetimit dhe administrimin e provave të paraqitura, lidhur me provueshmërinë e mundësisë financiare të huadhënësve për të dhënë shumat e deklaruara. Përveç sa më sipër dhe pretendimeve mbi analizën financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit në këto parashtrime, duke pretenduar se ka ndryshuar praktika dhe vihen re qasje të reja në interpretimin e rrethanave të ngjashme me ato të subjektit, ka referuar disa vendime të Komisionit⁹, si dhe ka sjellë në vëmendje të Kolegjit, vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”), në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, pasi në rastin e huadhënësve diskutohen të ardhurat e krijuara në emigracion nga ana e tyre, për periudha para procesit të rivlerësimit.

11.6.1. Trupi gjykues vlerëson se referencat në vendimmarrjet e tjera të Komisionit, nuk mund të përbëjnë *a priori* shkak për ta konsideruar të padrejtë qëndrimin e Komisionit në vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë vlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Vendimmarrja e Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, çfarë adreson rëndësinë e nënvizuar nga GjEDNj-ja për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës¹⁰, duke pasur në konsideratë këtu vetë vendimet e GjEDNj-së dhe vendosur standardet në bazë të parimeve kushtetuese, kur çështja gjykohet prej tij.

11.6.2. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me cenimin e nenit 8 të KEDNj-së, ngre në ankim pretendimin se shkarkimi nga detyra ka pasur një ndikim domethënës në mirëqenien e saj personale dhe të anëtarëve të familjes. Shkarkimi nga detyra, referuar jurisprudencës së GjEDNj-së¹¹ nuk ka qenë në përputhje me ligjin, nuk ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, nuk është proporcional, e për rrjedhojë, shkel nenin 8 të Konventës, pasi: (i) është bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nga leximi literal i të cilit kërkohet përmbushja e dy kushteve kumulative, të deduktuara nga përdorimi i lidhëzës “dhe”, pra deklaram i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë. Kur subjekti

⁹ Subjekti i rivlerësimit ka referuar vendimet e Komisionit nr. 394, datë 07.06.2021; nr. 16, datë 30.05.2018; nr. 76, datë 12.11.2018; nr. 13, datë 05.04.2018; nr. 105, datë 12.02.2019.

¹⁰ *Shih Beian v. Romania* (no. 1), §§ 37 dhe 39; *Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania* [GC], §§ 116-35.

¹¹ Ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit referon “*Xhoxhaj kundër Shqipërisë*” dhe “*Sevdari kundër Shqipërisë*”.

mund të rezultojë me deklarin të pamjaftueshëm të pasurisë, në një vlerë që është më e ulët se dyfishi i pasurisë, legjislatori ka kërkuar detyrimisht që kjo të jetë e shoqëruar edhe me probleme në kriterin e kontrollit të figurës. Sipas subjektit në ankim, **(ii)** Komisioni nuk ndoqi një qëllim legjitim, sepse pavarësisht hetimeve të thelluara dhe të gjithanshme, nuk arriti të gjente asnjë të dhënë, që subjekti i rivlerësimit të ishte e korruptuar, e lidhur me krimin e organizuar apo e paaftë, përkundrazi, në kriteret e kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale, nuk u konstatua asnjë problematikë. Ndërsa në kriterin e kontrollit të pasurisë, problematika kishte të bënte me provueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të personave të tjerë të lidhur për dhënien e huave bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

11.6.3. Trupi gjykues, lidhur me këtë interpretim të kuptimit dhe zbatimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nga ana e subjektit, sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimet e tij¹², në të cilat është theksuar se, pavarësisht që deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe i figurës janë përmbledhur në normimin ligjor, nenin 61, pika 3 e këtij ligji, bazuar në përcaktimin e qartë që jep neni D i Aneksit të Kushtetutës, lidhur me deklarimin e pamjaftueshëm në nivelin e ligjit, parashikon detyrimin e subjektit të rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të ardhurave të tij, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe nuk kërkon domosdoshmërisht konstatimin e problematikave në kontrollin e kriterit të figurës.

Për sa i përket pretendimit të subjektit, se procesi i rivlerësimit nuk ndoqi një qëllim legjitim, pasi ndaj saj u mor masa disiplinore vetëm për shkak të mosjustifikimit të pasurisë, ndërsa nuk u gjet asnjë problem në të dyja kriteret e tjera, trupi gjykues, sipas jurisprudence së konsoliduar të Kolegjit dhe të GjEDNj-së, vlerëson se një situatë e tillë procedurale, nuk bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi apo me qëllimin e ligjshëm të procesit të rivlerësimit, për arsye se kryerja e procesit vetëm për një kriter është e bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

11.6.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, së bashku me prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, me kërkesën e datës 06.03.2023, ka paraqitur në Komision prova shpresore shtesë, raportin financiar të datës 03.03.2023 dhe analizë të treguesve financiarë për periudhën 2002 – 2016, në një total prej 52 fletësh. Sipas subjektit, megjithëse Komisioni i ka pranuar këto akte në cilësinë e provës, më datë 07.03.2023, nga data e pranimit të tyre deri në datën e zhvillimit të seancës dëgjimore, më 09.03.2023, ka qenë objektivisht e pamundur për këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë që t'i vlerësojnë ato në mënyrë të plotë. Nëse këto prova do të ishin shqyrtuar së bashku me provat e tjera të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk do të rezultonte asnjë problem në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

11.6.5. Lidhur me pretendimin e subjektit për kohën e shkurtër që Njësia e Shërbimit Ligjor në Komision kishte në dispozicion për të shqyrtuar parashtrimet e subjektit dhe provat e paraqitura bashkëlidhur, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se një analizë objektive duhet të mbështetet në cilësinë e përmbajtjes dhe jo në sasinë e të dhënave, në raport me efektin që ato kanë në provimin e të kundërtës së rezultateve të hetimit. Nga aktet në dosjen gjyqësore, ndër 52 fletët e paraqitura nga subjekti, një pjesë e konsiderueshme e tyre¹³ i referohet treguesve të analizës financiare të kryer nga kontabilisti i miratuar P. XH., që sikurse e pranon edhe subjekti, mbështetet në të njëjtat akte të administruara nga Komisioni, por e hartuar me një metodologji të ndryshme nga ajo e ndjekur prej

¹² Shih vendimin nr. 1/2021 (JR); vendimin 15/2022 (JR) etj.

¹³ Rreth 22 faqe.

tij. Për më tepër që pjesa tjetër të akteve konsiston në certifikata familjare, deklarata noteriale, certifikata pronësie etj., të cilat Komisioni i ka pranuar në cilësinë e provës dhe i ka vlerësuar me objektivitet në vendimmarrjen e tij, më datë 13.09.2023.

Në përmbledhje, periudha kohore në dispozicion të Komisionit nga data e dorëzimit të këtyre akteve, më 06.03.2023, deri në datën e seancës së shpalljes së vendimit, më 13.03.2023, ka qenë 7 (shtatë) ditë. Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e akteve të paraqitura nga subjekti njiheshin nga Komisioni ose rezultuan pa ndikim për kontrollin e pasurisë, periudha shtatëditore nuk mund të vlerësohet e pamjaftueshme për shqyrtimin e tyre. Për pasojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit u vlerësua nga trupi gjykues, i pabazuar.

11.7. Në konkluzion të analizës më sipër, për kërkesat dhe shkaqet procedurale të paraqitura në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar në ligj kërkimin për riçeljen e hetimit gjyqësor për çështjen nr. 21/2023 (JR), datë 23.05.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, dhe çmon shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, mbi bazë aktesh të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, pasi në asnjë rast nuk gjendemi përpara kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

*Për pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 105.13 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 24.41 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*

12. Komisioni, në vendim lidhur me këtë pasuri, ka arritur në konkluzionin se: “[...] subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e saj me burime të ligjshme. [...] subjekti nuk arriti të provojë mundësinë financiare të personave të lidhur (3 huadhënësve) për dhënien e huave respektive me burime të ligjshme. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë bërë deklaram të pasaktë të pasurisë, duke mos u gjetur në kushtet e përcaktuara nga germa “a”, pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, subjekti është gjendur në kushtet e përcaktuara nga germa “b”, pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament + garazh”.

Nisur nga fakti që në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë specifikuar burimet financiare të kësaj pasurie në momentin e krijimit, por kanë deklaruar të gjitha të ardhurat e realizuara prej tyre dhe personat e tjerë të lidhur me ta, prej vitit 1989 e në vazhdim, Komisioni ka vlerësuar të kryejë analizën ligjore dhe financiare për çdo kësht.

13. Subjekti i rivlerësimit kundërshton arsyetimin dhe konkluzionet e Komisionit në vendim për pasurinë objekt shqyrtimi, për sa më poshtë:

Në lidhje me pagesën e kështit të parë në shumën 62.000 euro, në datën 17.10.2008

14. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se depozita me afat në emër të personit të lidhur, bashkëshortit, në Intesa Sanpaolo Bank ShA, në shumën 35.000 euro, e depozituar *cash* në datën 17.01.2007, ka shërbyer si burim për pagesën e kështit të parë të çmimit të apartamentit dhe garazhit në Tiranë, në shumën 62.000 euro. Në këto kushte, Komisioni kreu verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për krijimin e kësaj depozite, dhe arriti në

përfundimin se: “[...], subjekti nuk kishte burime financiare të ligjshme për krijimin e depozitës bankare prej 35.000 euro, në datën 17.01.2007, shumë e cila është përdorur për shlyerjen e kështit të parë për blerjen e pasurisë apartament + garazh”.

14.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim konkluzionet e mësipërme të Komisionit,¹⁴ bazuar kryesisht në të dhënat e raportit financiar,¹⁵ të paraqitur në Komision me prapësimet për rezultatet e hetimit dhe ankimin në Kolegj, duke ngritur këto pretendime:

(i) Kontabilisti i miratuar ka kryer analizën financiare sipas metodikës së përdorur nga Komisioni, por me një ndryshim thelbësor, që të gjitha të dhënat financiare të periudhës 1989 – 2002 (të ardhura, shpenzime, investime etj.), janë evidentuar në kolonë më vete, “viti 2002”. Përfshirja në vitin raportues 2003, edhe të dhënave financiare të viteve 1989 – 2002, ka bërë që shumat e ndryshimit të gjendjes së likuiditeteve të evidentuar në nënkategorinë “Likuiditete, ndryshim gjendje, shtesa/pakësime”, në vitin 2003, të jetë e pasaktë dhe e paargumentuar, dhe për rrjedhojë, në analizën financiare për vitin 2004 dhe vitet 2007 – 2011, kanë rezultuar me balanca negative, të pabazuara dhe të pajustificuara.

(ii) Nuk qëndron konkluzioni i Komisionit në vendim, se për vitin e mbyllur 2004, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për shtesën në kursime *cash*, në shumën 300.000 lekë, pasi me dokumente justifikuese, me të njëjtat të dhëna financiare të konfirmuara nga Komisioni dhe metodologjinë e përdorur nga kontabilisti, ka provuar se në fund të vitit 2004, subjekti rezulton me balancë pozitive (+) 862.952 lekë. Në kushtet kur, nga viti 2003 deri në fund të vitit 2004, ka rritje të ardhurash dhe rritje likuiditeti, atëherë logjikisht nuk mund të rezultojë dhe nuk mund të provohet që viti 2004 të jetë me balancë negative (-) 498.444 lekë, siç konstatohet nga Komisioni.

(iii) Absolutisht i pavlefshëm është dhe konkluzioni i Komisionit, se për periudhën deri në datën 31.12.2006, referuar deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore përkatëse, shumat e kursimeve *cash* nga Komisioni vlerësohet në shumën 2.450.000 lekë dhe 3.500 euro. Sipas subjektit në ankim, pas ndarjes nga jeta të dy prindërve të bashkëshortit,¹⁶ të gjitha kursimet që posedoheshin ndër vite prej tyre, përafërsisht rreth 1.700.000 lekë, së bashku me gjendjen në *cash* të rezultuar në fund të vitit 2006, në shumën 2.750.000 lekë, janë derdhur nga bashkëshorti më datë 17.01.2007, në bankën Intesa Sanpaolo ShA, të konvertuara në shumën 35.000 euro apo 4.355.775 lekë. Kursimet e prindërve të bashkëshortit dhe gjendja e likuiditetit e rezultuar në fund të vitit 2002, nuk është një burim i ri, por ka ekzistuar para fillimit të deklarimit të interesave personale të vitit 2003.

(iv) Nuk qëndron analiza, argumentet dhe konkluzionet e Komisionit në lidhje me pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumës 35.000 euro, në datën 17.01.2007, nëpërmjet së cilës është bërë edhe likuidimi i kështit të parë të apartamentit të blerë në Tiranë. Sipas hyrjeve dhe daljeve të parasë, analizës financiare dhe gjendjes së likuiditetit në arkë dhe në bankë, për periudhën 2002 – 2006, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi nga burime të deklaruara dhe të dokumentuara, për krijimin e depozitës së sipërcituar.

¹⁴ Subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit në paragrafët 1.43 - 1.63 të vendimit nr. 635, datë 13.03.2023, të Komisionit.

¹⁵ Subjekti mbështet ankimin e saj në “Raport financiar të datës 03.03.2023” (në vijim “Raporti financiar”) të hartuar nga kontabilisti i miratuar P. XH.

¹⁶ Përkatësisht në shkurt 2004, babai i bashkëshortit, dhe në mars 2005, nëna e tij.

(v) Nga të dhënat e raportit financiar rezulton që në fund të vitit 2002, familja e subjektit të rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur balancë të fondeve në shumën 3.472.710 lekë. Nisur nga fakti që deklarimi i gjendjes së likuiditeteve të prindërve nuk ka qenë detyrim ligjor, subjekti pretendon në ankim se, duke zbritur nga balanca e fondeve në shumën 3.472.710 lekë, të vitit 2002, depozitën prej 1.247.603 lekë, në emër të personit të lidhur, në Alpha Bank ShA, në vitin 2001, shuma e mbetur prej 2.225.107 lekë është evidentuar në raportin financiar, analiza financiare për periudhën 2002 – 2007, në zërin “*Gjendje cash e familjes me prindërit, krijuar gjatë viteve 1989 – 2002*”.

(vi) Në fillim të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka pasur një gjendje të konsiderueshme likuiditeti të mbartur nga viti 2007, në shumën totale prej 7.079.887 lekësh, ndërkohë që janë krijuar edhe gjendje të reja gjatë vitit 2008. Nisur nga fakti se likuidimi i shumës prej 62.000 euro është kryer në tetor të vitit 2008, për rrjedhojë, gjendja e likuiditetit e vitit paraardhës 2007 dhe gjendjet e reja të krijuara gjatë vitit 2008 vërtetojnë mbulimin e pagesës së kështit të parë në shumën 62.000 euro.

(vii) Qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, për të ardhurat e babait të personit të lidhur si i dënuar politik, në shumat 200.000 lekë dhe 720.000 lekë në letra me vlerë, konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 02.03.2023, të Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, është jo i qartë, pasi nuk specifikohet nëse i mori apo jo në konsideratë ato.

14.2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore të Komisionit, në përgjigje të pretendimeve të subjektit në ankim dhe në parashtrime, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

14.2.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, dorëzuar në datën 27.01.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sipërfaqe 105.13 m² dhe garazh me sipërfaqe 24.41 m², rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë, sipas kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***}, datë 03.12.2012¹⁷. Vlera 145.000 euro (nga të cilat 135.000 euro vlera e apartamentit dhe 10.000 euro vlera e garazhit). Pjesa takuese 50%.*

Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: -- (i) të ardhura neto nga puna si prokurore, gjyqtare, si dhe pagesë lehtësuese nga Shkolla e Magjistraturës, nga data 01.09.1989 deri më 31.12.2016; -- (ii) të ardhura neto të b/shortit nga puna si nd/gjyqtar, gjyqtar, pagesë papunësie, si dhe profesioni i avokatit nga 01.01.1994 – 31.12.2016; -- (iii) të ardhura nga pensioni nr. {***} [babai i b/shortit] në vitet 11.03.1990 – 16.02.2004; -- (iv) dëmshpërblim si i përndjekur politik [babai i b/shortit] në vitet 1995 – 2013; -- (v) të ardhura nga pensioni nr. {***} [nëna e b/shortit], në vitet 16.02.2004 – 28.05.2005; -- (vi) dëmshpërblim si trashëgimtarë të të përndjekurit politik [nëna e b/shortit], dhe sipas prokurës së posaçme nr. {***} rep./kol., datë 18.01.1995; -- (vii) të ardhura nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 62.58 m², lagjja nr. {***} në Laç, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep./kol., datë 10.01.2007, depozituar në llogarinë bankare nr. {***} në Intesa Sanpaolo Bank, tërhequr në datën 20.01.2009, vlera ½ e depozitës + interesat; -- (viii) të ardhura nga emigracioni, vëllezërit në Gjermani dhe Itali në vitet 2005 – 2009; -- (ix) të ardhura nga shitja e automjetit [autoveturë tip BMW 320, viti 1992], me kontratë nr. {***} rep./kol., datë 31.12.2009. Burim i kësaj kontrate, dhurim automjeti nr. {***} rep./kol., datë 09.08.2006; -- (x) të ardhura nga shija e tokës bujqësore [ullishte], me sipërfaqe 72,500 m², sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep./kol., datë 01.04.2008. Pasuri trashëgimore e b/shortit sipas pjesës takuese. Pasuri e paregjistruar për shkak se nuk ka regjistrim fillestar në qytetin e Krujës, sipas aktit të marrjes në

¹⁷ Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontratën e shitblerjes së apartamentit në fjalë.

pronësi nr. {***}, datë 09.09.1997; -- (xi) shitje trualli me sipërfaqe 500 m², sipas kontratë shitblerje noteriale nr. {***}, datë 08.10.2009 [pasuri trashëgimore e b/shortit nga nëna]; -- (xii) shitje trualli me sipërfaqe 180 m², sipas kontratë shitblerje noteriale nr. {***}, datë 08.10.2009 [pasuri trashëgimore e b/shortit nga nëna]; -- (xiii) të ardhura nga shitja e autoveturës tip Benz, 200 CDI, vit prodhimi 2000, me kontratë nr. {***} rep./kol., datë 18.12.2012 [fillimisht është blerë autoveturë Benz tip 124-200D vit prodhimi 1986, sipas kontratës nr. {***} rep./kol., datë 07.10.2002 i cili është shitur me kontratë nr. {***} rep./kol., datë 17.11.2006, dhe me të ardhurat nga kjo shitje është blerë autoveturë tip Benz 200 CDI, vit prodhimi 2000, me kontratë nr. {***} rep./kol., datë 25.04.2007]; - - (xiv) Likuidimi i vlerës së shtëpisë është bërë me këste, duke filluar që nga viti 2008 – 2012. Për likuidimin e kësaj vlere janë përdorur edhe huat e marra ndaj personave të tretë, përkatësisht me kontratën e datës 17.01.2009, të datës 02.07.2010, si dhe atë të datës 01.03.2011¹⁸; (xv) -- depozitat bankare në Alpha Bank, A. E., nr. {***}, në lekë, e datës 26.07.2001, -- nr. {***}, në euro, e datës 08.08.2007, me interesat e tyre, janë përdorur për likuidimin e kësteve të shtëpisë, si dhe llogaria te Intesa Sanpaolo ShA, me nr. {***}, datë 17.01.2007.

14.2.2. Në deklaratën periodike vjetore 2008, personi i lidhur me subjektin për këtë pasuri deklaroi: Kontratë sipërmarrje datë 06.10.2008, për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 115.29 m² dhe një vend parkimi automjeti në vlerën 172.172 euro, shlyer kësti i parë në shumën 62.000 euro, për apartamentin, me burim: (i) [...] tërhequr nga banka Intesa Sanpaolo shuma 36.600 euro; (ii) të ardhura cash 19.990 euro dhe (iii) gjendje të deklaruara nga bashkëshortja në vitet paraardhëse.

14.2.3. Me shkresën nr. {***} prot., datë 03.08.2022, ILDKPKI ka përcjellë në Komision procesverbalin e datës 06.12.2011, “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, në të cilin subjektit i është kërkuar, ndër të tjera, të paraqesë kontratën e blerjes së apartamentit dhe garazhit të deklaruar në vitin 2008. Subjekti ka paraqitur kontratën e datës 01.11.2010 (shkresë e thjeshtë), sipas së cilës bashkëshorti i subjektit ka porositur pranë shoqërisë “{***}” ShPK ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe ndërtimi 115.29 m² dhe të një post parkimi. Çmimi i apartamentit dhe i postit të parkimit është në vlerën 145.000 euro, nga i cili porositësi ka likuiduar, deri më datë 30.10.2010, shumën prej 119.609 euro. Porositësi do të paguajë këstin e fundit, në shumën prej 25.391 euro, deri më datë 30.06.2011. Sa i përket diferencës mes çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazhit të deklaruar në vitin 2008, në shumën 172.172 euro, dhe atij në kontratën e datës 01.11.2010, në shumën 145.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: kontrata e datës 01.11.2010 është kontrata përfundimtare, pas rivlerësimit të punimeve të bëra nga firma “{***}” ShPK. Ndërsa, çmimi fillestar i kontratës së sipërmarrjes është çmimi i deklaruar nga ana ime në deklaratën 2008, pra vlera është 172.172 euro.

14.2.4. Në përgjigjet e datës 26.09.2022, të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, në lidhje me konstatimet mbi mospërputhjen e çmimit të deklaruar në vitin 2008 prej 172.172 eurosh, me atë të kontratës së shitblerjes të vitit 2012, në shumën 145.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: [...] mospërputhja e çmimit [...] ka ardhur për faktin se kontrata e sipërmarrjes është ndryshuar me vullnetin e palëve, pas rakordimit të punimeve, që janë pasqyruar në procesverbalin e mbajtur në

¹⁸ Sikurse ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting, likuidimi i vlerës së shtëpisë është bërë me këste, duke filluar nga viti 2008 deri në vitin 2012, për të cilat janë përdorur edhe huat e marra nga persona të tretë, përkatësisht me kontratat e datës 17.01.2009, hua në shumën 20.000 euro, nga shtetasi A. S. L., të datës 01.03.2011, hua në shumën 5.000.000 lekë, nga shtetasi P. Sh. H., dhe kontratën e datës 02.07.2010, hua në shumën 15.000 euro, nga shtetasi P. S. SH. Marrëdhëniet e huas me persona të tretë dhe shumën e detyrimit të mbetur për to, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës së pasurisë vetting dhe në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të së njëjtës deklaratë.

datën 30.10.2010, ku janë listuar të gjitha ndryshimet e bëra gjatë ndërtimit të objektit, nga shoqëria “{***}” ShPK, të cilat kanë sjellë uljen e kostos së ndërtimit të objektit në tërësi, e për pasojë, dhe uljen e çmimit përfundimtar të shitjes. Ndryshimet në ndërtim kanë ndodhur për shkak të materialeve të termoizolimit (veshjes) së fasadës së jashtme të objektit, në ngrohjen qendrore, në heqjen e mobilimit të brendshëm (kuzhina berloni) etj., si dhe heqjen e disa punimeve të brendshme nga porositësi, të cilat janë kryer vetë më pas [...].

14.2.5. Subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga sa parashikohet në kontratën e datës 06.10.2008 (shkresë e thjeshtë)¹⁹, ka deklaruar se pagesat për shlyerjen e çmimit të shitjes së apartamentit dhe garazhit, në shumën 145.000 euro, janë kryer nga personi i lidhur me bankë dhe në arkën e shoqërisë (cash), konkretisht: (i) më datë 17.10.2008, është paguar kësti i parë, në total 62.000 euro, nga të cilat 25.100 euro në arkë dhe diferenca prej 36.900 euro, në bankë; (ii) më datë 20.03.2009, është paguar në bankë shuma 30.000 euro; (iii) më datë 02.07.2010, është paguar në bankë shuma 30.000 euro; (iv) më datë 07.01.2011, është paguar në bankë shuma 13.000 euro dhe (v) më datë 30.06.2011, është paguar në bankë shuma 12.391 euro.²⁰

14.2.6. Sipas të dhënave të përcjella në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 12.07.2022, nga Intesa Sanpaolo Bank ShA, rezulton se nga llogaria në emër të bashkëshortit të subjektit në këtë bankë, në datën 17.10.2008, është transferuar shuma 36.900 euro, në llogarinë e shtetasit B. U., me përshkrimin: “shlyerje për blerje apartamenti”. Shuma e transferuar e ka origjinën te depozita 35.000 euro, e derdhur cash nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit më datë 17.01.2007. Nga analizimi i deklarimeve periodike, Komisionit i ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2007, shtimin e kësaj depozite, por jo burimin e krijimit të saj.

14.2.7. Në këto kushte, e pyetur nga Komisioni për burimin e krijimit të shumës 35.000 euro, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *shuma prej 35.000 euro, e depozituar në bankën Intesa Sanpaolo ShA [ish-Banka Amerikane]: (i) janë kursime nga puna e përbashkët; (ii) tërheqje nga bankat në lekë/euro; (iii) shitje autoveture tip Benz; (iv) gjendje cash në lekë/euro; (v) e të ardhura të tjera të krijuara sipas deklarimeve në DPV-të e viteve të mëparshme.* Për vlerën e shpenzimeve shtesë të deklaruara dhe burimin e të ardhurave për mbulimin e tyre, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: [...] *punimet e kryera në vitin 2009 janë në vlerën 52.500 lekë, por nga kjo shumë, në këtë vit, është paguar vetëm vlera prej 35.252 lekë (pjesa e mbetur, paguar në vitin 2010), dhe si burim kanë shërbyer të ardhurat nga paga dhe biznesi i bashkëshortit. [...] në vitin 2010 është paguar shuma prej 639.404 lekë, për punime të kryera, duke ndarë burimin e të ardhurave, për periudhën janar – qershor 2010, të ardhurat nga puna dhe biznesi i bashkëshortit në vlerën*

¹⁹ Referuar kontratës datë 06.10.2008 (shkresë e thjeshtë), rezulton se është parashikuar që pagesa të bëhet me këste periodike, sipas fazës së kryerjes së punimeve, si më poshtë: (i) porositësi ka paguar këstin e parë të blerjes së apartamentit që premtohet, në vlerën 51.000 euro, me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes; (ii) porositësi do të paguajë këstin e dytë në shumën 51.000 euro deri në datën 30.02.2009; (iii) porositësi do të paguajë këstin e tretë në shumën 51.000 euro deri në datën 30.10.2009 dhe (iv) kësti i fundit, në shumën 19.170 euro, do të paguhet me firmosjen e procesverbalit dhe marrjen në dorëzim të ambientit.

²⁰ Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur pyetësorit dokumentacionin për të vërtetuar pagesat e kryera për likuidimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie: (i) mandatpagesë nr. {***}, datë 17.10.2008; (ii) transfertë bankare e datës 17.10.2008, në ISP Bank ShA; (iii) transfertë bankare e datës 20.03.2009, në ISP Bank ShA; (iv) transfertë bankare datë 02.07.2010, në ISP Bank ShA; (v) transfertë bankare e datës 07.01.2011 në ISP Bank ShA; (vi) mandat arkëtimi nr. {***}, datë 30.06.2011, i shoqërisë “{***}” ShPK. Po ashtu dhe kontratën e sipërmarrjes, datë 01.11.2010, si dhe procesverbal të datës 30.10.2010 (shkresë e thjeshtë), mes përfaqësuesit të shoqërisë “{***}” ShPK dhe porositësit L. M., në të cilin shkruhet se: ndryshimet e bëra gjatë ndërtimit të objektit nga shoqëria kanë sjellë ndryshime në koston e objektit, për rrjedhojë, ndryshim të çmimit të apartamentit dhe të postit të parkimit, duke rënë dakord për çmimin total prej 145.000 euro (135.000 euro, apartamenti dhe 10.000 euro, garazhi).

138.530 lekë, dhe për periudhën korrik – nëntor 2010, nga shuma e mbetur (500.874 lekë), nga huaja e z. P. H.²¹ Pra, subjekti ka deklaruar se vlera e shpenzuar për punimet në apartamentin në rrugën “{***}”, Tiranë, është në vlerën 676.656 lekë (37.252 lekë në vitin 2009 dhe 639.404 lekë në vitin 2010).

14.2.8. Nisur nga burimet e deklaruara, Komisioni shqyrtoi deklaratat periodike vjetore, nga analizimi i të cilave konstatoi se:

- Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie 2003 (në vijim: “deklarata e pasurisë, 2003”), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *gjendje cash në banesë në shumën 0.6 milion lekë, me burim kursime familjare ndër vite.*
- Në deklaratën periodike vjetore 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *gjendje cash në shumën 300.000 lekë, vit krijimi 2004.*
- Në deklaratën periodike vjetore 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *shuma e pakësuar në llogarinë e bashkëshortit është cash 750.000 lekë.*
- Në deklaratën periodike vjetore 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *gjendje cash në shumën 1.100.000 lekë, si dhe gjendje cash 3.500 euro (ardhur nga emigracioni, në datën 15.11.2006, në Bankën Popullore, nga shtetasit N. dhe A. G.).*

14.2.9. Mbështetur në sa deklaroi subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, për burimet e krijimit, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë, nga e cila ka rezultuar se për vitin e mbyllur 2004, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për shtesën në kursime *cash* në shumën 300.000 lekë dhe kryerjen e shpenzimeve në këtë vit. Me konsideratë sa më sipër, Komisioni, për periudhën deri në datën 31.12.2006,²² vlerësoi se shuma e kursimeve *cash* ka qenë 2.450.000 lekë (2.750.000 lekë – 300.000 lekë) dhe 3.500 euro. Me këtë arsyetim, Komisioni kreu analizën financiare për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të kursyer shumën 35.000 euro deri më datë 17.01.2007, të përdorur si burim për pagesën e kështit të parë të çmimit të apartamentit dhe garazhit, në Tiranë, në datën 17.10.2008. Balanca negative e kësaj analize, në shumën (-) 1.236.543 lekë, tregoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ndodhen në pamundësi financiare për të krijuar kursime *cash* në shumën 35.000 euro, për periudhën 2003 – 17.01.2007.

14.2.10. Në këto kushte, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, lidhur me mospërputhjet dhe pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar, konkretisht: **(i)** mes çmimit të deklaruar të paguar, në shumën 145.000 euro, dhe atij sipas dokumentacionit të sjellë nga vetë subjekti, në shumën 147.391 euro; **(ii)** mes kohës së pagesës së kështit të parë, pasi referuar kontratës së datës 06.10.2008, shuma prej 51.000 euro është likuiduar në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti, kështi i parë, në shumën 62.000 euro, është

²¹ Subjekti ka bashkëlidhur, ndër të tjera, edhe: (i) fletëdalje datë 25.08.2009, në vlerën 288 euro; (ii) fletëdalje datë 15.08.2009, në shumën 7.370 lekë; fletëdalje datë 05.11.2009, në shumën 6.280 lekë; dokument datë 06.11.2009, për shumën 1.600 lekë; preventiv i datës 30.01.2010, nga shoqëria “{***}” ShPK, për shumën 5.320 lekë; mandat arkëtimi i datës 24.02.2010, në shumën 20.570 lekë; fletëdalje e datës 19.04.2010, në shumën 12.600 lekë; fletëdalje e datës 29.05.2010, për shumën 18.600 lekë; mandatarëkim i datës 02.08.2010, në shumën 700 euro; fletëdalje 8/2010, për dyer të brendshme dhe mandatpagesë në shumën 78.000 lekë; printim fature shitje datë 06.08.2010, në shumën 134.150 lekë; printim fature shitje e datës 12.09.2010, në shumën 176.000 lekë; fletëdalje e datës 13.03.2010, në shumën 2.756 lekë (pa emër); dokument scontrino, i datës 13.03.2010, për nxjerrje nga magazina mallra/materiale në shumën 24.100 lekë; dokument scontrino, i datës 21.04.2010, për nxjerrje nga magazina mallra/materiale në shumën 15.253 lekë; fletëdalje e datës 21.04.2010, në shumën 26.914 lekë; fletëdalje e datës 08.06.2010, në shumën 10.267 lekë.

²² Subjekti në deklaratën periodike të vitit 2007 nuk deklaroi pakësim të vlerave monetare *cash* në banesë.

paguar më datë 17.10.2008; **(iii)** në lidhje me pagesën e kështit të fundit të çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazhit, pasi në deklaratën periodike vjetore 2011 është deklaruar e paguar në datën 30.06.2011, shuma 25.391 euro,²³ ndërsa në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 shpjegohet që kjo shumë është paguar në dy këste, me bankë, i pari në datën 07.01.2011, në vlerën 13.000 euro, dhe kësti tjetër, në datën 30.06.2011, në vlerën 12.391 euro, si dhe për mungesën e burimeve financiare të ligjshme të konstatuar nga analiza financiare paraprake e kryer prej tij, për krijimin e depozitës në shumën 35.000 euro, në datën 17.01.2007.

14.2.11. Në përgjigje të barrës së provës: **(i)** lidhur me mospërputhjet e rezultuara mbi çmimin e apartamentit dhe garazhit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se çmimi i shitjes është 145.000 euro. Ndryshimi i pagesave të kryera, nga 145.000 në 147.391 euro, vjen si rezultat i parapagesës së disa shpenzimeve shtesë, të cilat arrijnë afërsisht shumën 2.391 euro. **(ii)** Në lidhje me pagesën e kësteve, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, pavarësisht parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes së datës 06.10.2008, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, janë paraqitur të gjitha mandatpagesat përkatëse, referuar të cilave nuk rezulton që likuidimi i kësteve të jetë bërë sipas kontratës, pasi shuma prej 51.000 eurosh nuk është paguar në datën e lidhjes së saj, sikurse parashikohet në kontratë, por është likuiduar më datë 17.10.2008, shuma 62.000 euro, sipas marrëveshjes mes palëve. **(iii)** Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kësti i fundit është paguar në dy pjesë, shuma 13.000 euro, në datën 07.01.2011 dhe diferenca prej 12.391 euro, në datën 30.06.2011. Deklarimi në deklaratën periodike vjetore 2011 është bërë për efekt të shlyerjes/përmbushjes së detyrimit në total. **(iv)** Në kuadër të sqarimeve për mungesën e burimeve financiare të ligjshme të konstatuar nga Komisioni për krijimin e depozitës 35.000 euro, në Intesa Sanpaolo Bank ShA, më datë 17.01.2007, subjekti i rivlerësimit ka depozituar “Raport financiar, datë 03.03.2023”, të hartuar nga kontabilisti i miratuar, P. XH. Nisur nga rezultatet e analizës financiare të kryer prej tij për periudhën 2002 – 2007, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ajo, personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, duke pretenduar se, pas ndarjes nga jeta të dy prindërve të bashkëshortit, në shkurt 2004, babai dhe në mars 2005, nëna e tij, të gjitha kursimet që posedoheshin ndër vite prej tyre, afërsisht 1.700.000 lekë, së bashku me gjendjen *cash* të rezultuar në fund të vitit 2006, në shumën 2.750.000 lekë, janë derdhur në bankën Intesa Sanpaolo ShA, në datën 17.01.2007, si depozitë në shumën 35.000 euro ose 4.355.775 lekë, e konvertuar me kursin mesatar të këmbimit në këtë datë.

14.2.12. Komisioni ka vlerësuar se, ndonëse gjatë hetimit administrativ u konstatuan mospërputhje të çmimit të deklaruar me atë të dokumentuar të paguar, në analizën financiare paraprake janë pasqyruar në kohë dhe vlerë shumat e paguara sipas dokumentacionit provues të sjellë nga subjekti i rivlerësimit²⁴. Edhe pse nga ana e subjektit të rivlerësimit, kursimet e prindërve të bashkëshortit të saj, për periudhën 1989 – 2002, u pretenduan si burim për krijimin e depozitës 35.000 euro, më datë 17.01.2007, vetëm pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit, Komisioni ka marrë në analizë dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar ligjshmërinë e kursimeve të prindërve të pretenduara në shumën 1.7 milionë lekë, specifikisht: (i) kursimet nga pensionet; (ii) të ardhura të përfituara nga dëmshpërblimi si i përndjekur politik i babait të bashkëshortit dhe nënës së tij si trashëgimtare ligjore e babait të saj; (iii) të ardhura nga puna në

²³ Referuar deklarimeve të subjektit dhe personit të lidhur në këtë vit.

²⁴ Komisioni ka vlerësuar se mospërputhja e çmimit të përcaktuar në kontratën e shitjes me vlerën e paguar nga subjekti, sipas veprimeve bankare dhe në arkë, të kryera për këtë pasuri, ka ardhur si rezultat i pagesave shtesë të kryera nga subjekti, të cilat arrijnë shumën 2.391 euro, në total.

veprimtari private bujqësore ndër vite; (iv) kontribute ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe i personit të lidhur me të, si dhe nga kontributi i fëmijëve të tjerë të familjes *Merlika*.

14.2.13. Në analizë të dokumentacionit të sipërcituar, Komisioni ka vlerësuar se: (i) Të ardhurat nga pensionet e prindërve të bashkëshortit kanë qenë në shumën 707.205 lekë, për periudhën 04.03.1986 – 28.05.2005. (ii) Të ardhurat e babait të bashkëshortit të pretenduara nga dëmshpërblimi si i përndjekur politik, në bazë të shkresës nr. {***} prot., datë 24.02.2023, të Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave, në shumën 542.000 lekë (dosje {***}), kanë filluar të shpërndahen në vitin 2009, jashtë periudhës nën analizë. Sa i përket të ardhurave të nënës së bashkëshortit, si trashëgimtare e të dënuarit politik, z. D. P., nga verifikimet rezultoi se nuk është i miratuar në asnjë nga listat e VKM-ve të ardhura në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë nga Ministria e Drejtësisë. Ndërsa, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 02.03.2023, të Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, rezulton se ish - i dënuari P., ka përfituar shumën në të holla në masën 200.000 lekë dhe në masën 720.000 lekë në letra me vlerë, por në shkresë nuk përcaktohet koha e përfitimit të këtyre shumave. (iii) Sa i përket pretendimeve lidhur me të ardhurat e përfituara nga veprimtaria private bujqësore ndër vite dhe kontributi i subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur dhe fëmijëve të tjerë, Komisioni ka vlerësuar që ato kanë qenë deklarative, të padokumentuara me dokumentacion justifikues ligjor, si për vlerën, për kohën e përfitimit, ashtu edhe për ligjshmërinë e tyre. (iv) Sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në prapësime, se sipas analizës financiare të kryer nga kontabilisti i miratuar, për periudhën 2002 – 2007, ajo dhe personi i lidhur kanë pasur kursime të mundshme për krijimin e depozitës 35.000 euro në datën 17.01.2007, Komisioni ka vlerësuar se kursimet e pretenduara nga ana e saj, nuk mund të merren në konsideratë, pasi ato nuk janë deklaruar prej saj në deklaratat periodike vjetore apo në çdo lloj forme sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

14.2.14. Në përmbledhje të sa më sipër, në kushtet që subjekti i rivlerësimit: (i) nuk i ka deklaruar në deklaraten e pasurisë *vetting*, në deklaratat periodike vjetore, si dhe gjatë hetimit, kursimet e prindërve si burim; (ii) nuk i ka deklaruar kursimet e prindërve në shumën 1.7 milionë lekë as si gjendje *cash* apo në ndonjë formë tjetër (të ardhura ose dhurim) në deklaratat periodike vjetore përkatëse, si dhe (iii) nuk provoi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me krijimin e pasurisë *depozitë bankare në shumën 35.000 euro*, më datë 17.01.2007, e përdorur për shlyerjen e kështit të parë të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

14.2.15. Trupi gjykues, në parantezë të analizës vijuese mbi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të përcaktimit të kohës së shlyerjes së kështit të parë të pasurisë objekt vlerësimi, sikurse edhe Komisioni në vendim, çmon të konsiderojë me vlerë provuese dokumentacionin justifikues të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe deklaramet e kryera në deklaratat periodike vjetore, duke zbatuar në këtë mënyrë edhe parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se kështi i parë, në vlerën 62.000 euro, të analizohet i shlyer në vitin 2008, sikurse ka deklaruar bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaraten periodike përkatëse, me burim të deklaruar: (i) *tërhequr nga ISP Bank ShA, shuma 36.600 euro*²⁵; (ii) *të ardhura cash 19.990 euro dhe gjendje të deklaruara nga bashkëshortja në vitet paraardhëse*²⁶.

14.2.16. Në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi

²⁵ Shuma e transferuar prej 36.900 euro, në datën 17.10.2008, është formuar si rezultat i maturimit të depozitës me afat, në emër të bashkëshortit të subjektit në këtë bankë, në shumën 35.000 euro (depozituar cash, në datën 17.1.2007) dhe interesit përkatës të llogaritur.

²⁶ Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, si kohë të shlyerjes së kështit të parë, ka deklaruar se, në datën 17.10.2008, është paguar në arkë, shuma 25.100 euro dhe në bankë, shuma 36.900 euro.

gjykues konstaton se, në deklaratën periodike vjetore 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtuar llogaria bankare, L. M., 35.000 euro*, pa deklaruar burimin e të ardhurave për krijimin e shumës të depozituar *cash* në bankë, më datë 17.01.2007. Referuar procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI, më datë 06.12.2011²⁷, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se burimi i krijimit të kësaj depozite është gjendja *cash* që subjekti ka disponuar në shtëpi, dhurata në lekë që i kanë sjellë vëllezërit nga emigracioni, si dhe të ardhura të realizuara nga aktiviteti i bashkëshortit. Ndryshe nga sa ka deklaruar në ILDKPKI, në përgjigje të pyetësorit, nr. 2, datë 26.09.2022, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *[...], shuma prej 35.000 euro, e depozituar në ISP Bank (ish-Banka Amerikane), janë kursime nga puna e përbashkët, tërheqjet nga bankat në lekë/euro, shitje autoveture tip Benz, gjendje cash në lekë/euro, të ardhura të tjera të krijuara sipas deklarimeve DIPV, në vitet e mëparshme 2005 dhe 2006, nga gjendjet cash, si në lekë apo euro, të cilat janë depozituar më datë 17.01.2007.*

14.2.17. Në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij ligji, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar hollësisht atë dhe *burimin e krijimit të saj*. Nga aktet në dosjen gjyqësore, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në deklaratën periodike vjetore 2007, shtimin e llogarisë bankare në Intesa Sanpaolo ShA, në shumën 35.000 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj.

14.2.18. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar as në procesverbalin e ILDKPKI-së apo në përgjigje të pyetësorit nr. 2, si burim për krijimin e likuiditeteve në llogarinë bankare, përdorimin e kursimeve të prindërve të bashkëshortit, ndër vite. Vetëm në përgjigje të barrës së provës, pas evidentimit të pamundësisë financiare nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se si burim për krijimin e këtyre likuiditeteve kanë shërbyer kursimet e viteve të mëparshme të prindërve të bashkëshortit, afërsisht 1.700.000 lekë, të cilat i kanë kaluar subjektit dhe personit të lidhur, pasi ata janë ndarë nga jeta. Këto kursime në *cash*, të pretenduara nga subjekti si burim krijimi të depozitës 35.000 euro, në janar 2007, nuk kanë lënë gjurmë në asnjë nga deklaratat periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur, që shërbejnë si provë në këtë proces apo në procesverbalet e ILDKPKI-së dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimet e krijimit të kësaj depozite, ka ndryshuar deklarimet gjatë hetimit administrativ, në një kohë të avancuar të procesit të rivlerësimit, kur u identifikuan problematikat me natyrë financiare për krijimin e depozitës, dhe çmon të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka shtuar një burim të ri për krijimin e saj. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kursimet e prindërve të bashkëshortit të subjektit, të pretenduara si burim krijimi të depozitës 35.000 euro, nuk përmbushin kriteret e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

14.2.19. Për shkakun ankimor të ngritur nga subjekti i rivlerësimit, *se përfshirja në vitin raportues 2003 edhe të dhënave financiare të viteve 1989 – 2002, ka bërë që shuma e ndryshimit të gjendjes së likuiditeteve të evidentuar në nënkategorinë “Likuiditete, ndryshim gjendje, shtesa/pakësime”, në vitin 2003, të jetë e pasaktë dhe e paargumentuar, dhe për rrjedhojë, në analizën financiare për vitin 2004 dhe vitet 2007 – 2011, kanë rezultuar me balanca negative, të pabazuara dhe të pajustificuara*, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, kaluar subjektit të rivlerësimit barrë prove me rezultatet e hetimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka kryer analizën financiare për të gjithë periudhën 1989 – 2003 në total dhe për periudhën 2004 – 2016, për secilin vit përkatësisht. Nisur nga parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve

²⁷ Përgjigje të pyetjes nr. 15.

financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenet 4²⁸ dhe 6²⁹ të tij, trupi gjykues e vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të kryer çdo vit më vete analizën për verifikimin e situatës së saj financiare, duke filluar nga viti 2003 e në vijim, ndërsa argumenton se Komisioni, nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në *deklaratën e pasurisë të vitit 2003*, gjendje *cash* në banesë 0.6 milion lekë, *me burim, kursime familjare ndër vite*, ka verifikuar mundësinë kumulative të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të krijuar këtë gjendje *cash* në fund të vitit 2003, duke kryer analizën financiare për të gjithë periudhën 1989 – 2003. Balanca kumulative e rezultuar duhet të jetë e barabartë me balancën e rezultuar për periudhën 1989 – 2002, shtuar atë të rezultuar për vitin 2003. Në këto kushte, nuk konstatohet problematikë në analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit. Gjithsesi, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, e ka kryer këtë analizë, të ndarë për periudhën 1989 – 2002, veçmas nga viti 2003, rezultatet e së cilës janë trajtuar në vijim.

14.2.20. Në përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, *se nga të dhënat e raportit financiar rezulton që në fund të vitit 2002, familja e subjektit të rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur balancë të fondeve në shumën 3.472.710 lekë, dhe duke zbritur nga kjo balancë, depozitën prej 1.247.107 lekë të bashkëshortit në Alpha Bank ShA, në fund të vitit 2002, shuma e mbetur prej 2.225.107 lekë ka qenë gjendje cash e familjes me prindërit*, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe, bazuar në të dhënat e dokumentacionit justifikues ligjor,³⁰ verifikoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, të personit të lidhur dhe prindërve të bashkëshortit, në kuadër të regjimit të përbashkët familjar³¹, për të krijuar kursimet e akumuluar të pretenduara në vlerën 2.225.107 lekë, për periudhën 1989 – 2002, sikurse pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në ankim. Rezultatet e analizës treguan mundësi kursimi të familjes së subjektit të rivlerësimit përfshirë prindërit e bashkëshortit, në shumën 870.878 lekë, dhe jo në masën 2.225.107 lekë, të pretenduar nga subjekti. Për këtë arsye, në vlerësim të trupit gjykues, pretendimi më sipër i subjektit të rivlerësimit gjendet i papabuar.

14.2.21. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se nga gjendja cash e familjes me prindërit, krijuar gjatë viteve 1989 – 2002, prej 2.225.107 lekë, vetëm shuma prej 1.700.000 lekë, e kaluar pasi prindërit e bashkëshortit janë ndarë nga jeta, kanë shërbyer si një ndër burimet për krijimin e depozitës 35.000 euro, në datën 17.01.2007, në bankën Intesa Sanpaolo ShA*, trupi gjykues vëren se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto kursime si burime të krijimit të depozitës në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklaratën periodike të vitit 2007, në ILDKPKI, në përgjigje të

²⁸ Neni 4, “Afati dhe objekti i deklarimit” parashikon se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...],

d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

²⁹ Neni 6, “Deklarimi i parë”, parashikon se: “Të gjitha subjektet [...] që mbartin detyrimin për deklarim, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre”.

³⁰ Në analizën financiare janë konsideruar të dhënat sipas dokumentacionit provues në dosjen gjyqësore të Komisionit, dhe për të cilat është vlerësuar se plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për të ardhurat e përfituara nga veprimtaria private bujqësore ndër vite dhe kontributi i fëmijëve të tjerë, ashtu sikurse ka arsyetuar edhe Komisioni në vendim, në vlerësim të trupit gjykues, këto pretendime mbeten në nivel deklarativ dhe të padokumentuara, si për sa i përket vlerës, kohës së përfitimit, ashtu edhe ligjshmërisë së tyre.

³¹ Pasi figurojnë në të njëjtën certifikatë familjare, të lëshuar nga Njësia Administrative Krujë, Zyra e Gjendjes Civile, për periudhën 15.03.1996 – 31.12.2009.

pyetësorëve; (ii) vetë subjekti në shkaqet e ankimit referon masa të ndryshme kursimi të prindërve si burim për krijimin e depozitës në analizë³² dhe se (iii) nga rezultatet e analizës financiare rezultoi që subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur dhe prindërit e bashkëshortit, nuk justifikojnë me të ardhurat e tyre të ligjshme, krijimin e shumës së pretenduar prej tyre, deri në fund të vitit 2002. Në këto rrethana, trupi gjykues e vlerëson edhe këtë pretendim të subjektit, të pabazuar. Të ardhura të ligjshme për efekt të këtij procesi konsiderohen ato të ardhura, të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të jenë deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore për to.

14.2.22. Lidhur me pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, *se analiza e kryer për vitin 2004, sipas treguesve financiarë dhe konfirmimeve të vetë Komisionit, rezulton me balancë pozitive (+) 993.266 lekë, dhe e kryer me të njëjtat të dhëna, por me metodologjinë e përdorur nga eksperti, rezulton po me balancë pozitive (+) 862.952 lekë*, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, konstaton se në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *gjendje cash 300.000 lekë, viti i krijimit 2004*. Në “Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, mbajtur në ILDKPKI, më datë 06 dhjetor 2011, inspektori ka konstatuar: *[...] për vitin 2004 keni deklaruar shtesë në shumën prej 300.000 lekë*, konstatim ky i pakundërshtuar nga subjekti në përgjigjet e dhëna në ILDKPKI. Nga sa më lart, bazuar edhe në detyrimin për deklarimin e shtesave dhe pakësimeve të pasurive paluajtshme e të luajtshme nga deklarimi i mëparshëm sipas ligjit të zbatueshëm, trupi gjykues ka vlerësuar të konsiderojë shumën 300.000 lekë, si shtesë gjendjes likuiditetesh në *cash*, në fund të vitit 2004.³³ Me këtë arsyetim, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues kontrollon analizën financiare të kryer në Komision për vitin 2004, nga e cila rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin shtesës së likuiditeteve si *cash*, ashtu edhe në bankë në këtë vit, për një balancë negative në shumën (-) 498.443 lekë.³⁴

14.2.23. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se është absolutisht i pavlefshëm konkluzioni i Komisionit që, për periudhën deri në datën 31.12.2006, referuar deklaratimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore përkatëse, shuma e kursimeve cash ka qenë 2.450.000 lekë dhe 3.500 euro, pasi, mbështetur në të dhënat dhe metodologjinë e përdorur nga Komisioni, u provua përmes analizës së paraqitur nga kontabilisti i miratuar se viti 2004, 2007, 2008, 2009 dhe 2011 kanë rezultuar me balancë pozitive*, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues vëren se analiza për periudhën 2002 – 2007, në raportin financiar është kryer nga kontabilisti i miratuar, mbi të dhënat e analizës së Komisionit, por në aplikim të metodologjisë kumulative për të gjithë periudhën më sipër, edhe pse ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, në nenin 4 të tij, parashikon qartë objektin e deklarimit të subjekteve që i nënshtrohen këtij ligji, me qëllim mundësimin e kontrollit periodik tyre nga organi kontrollues. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kontabilistit të miratuar, e ka kryer analizën financiare sikur të ishte subjekt tregtar, duke mbartur tepricat e viteve paraardhëse në vitet pasuese. Për më tepër, që mbart nga viti 2002 gjendje *cash* të familjes me prindërit, të krijuar gjatë viteve 1989 – 2002, në vlerën 2.225.107 lekë, të padeklaruar në

³² Subjekti në ankimin e tij i pretendon këto kursime njëherë në shumën 1.7 milionë lekë, më pas në 2.2 milionë lekë dhe në vijim, 1.6 milionë lekë.

³³ Trajtuar gjerësisht në vijim, në përgjigje të shkakut ankimor lidhur me analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

³⁴ Pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron edhe për faktin se analiza financiare është kryer nëpërmjet kontabilistit të miratuar, pa konsideruar ndryshimin e gjendjes së likuiditetit për vitin 2004, prej 1.491.709 lekësh [+ 1.191.709 lekë në bankë + 300.000 lekë cash]. Me përfshirjen e kësaj gjendje, rezultati i analizës do të ndryshonte (-) 628.757 lekë dhe jo 2.956.948 lekë, që paraqitet në analizën e vitit 2004 në raportin financiar [1.553.058 lekë “të ardhura” – 690.106 lekë “shpenzime” = + 862.952 lekë “mundësi për kursim”/2004 – 1.491.709 lekë ndryshim gjendje likuiditeti/2004].

deklaratën e pasurisë 2003, ndërkohë që nga kontrolli i analizës së kryer në Kolegj, ashtu si edhe në Komision, ka rezultuar në pamundësi financiare për të krijuar këto kursime. Në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm, në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se, për efekt të këtij procesi, kursimet *cash* konsiderohen në analizë, vetëm nëse janë deklaruar dhe provohet mundësia financiare e krijimit të tyre me të ardhura të ligjshme. Sa më sipër, trupi gjykues, sikurse edhe Komisioni në vendim, në analizë të deklarimeve periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit mbi gjendjen *cash*, vlerëson që gjendja e kursimeve në *cash*, në fund vitit 2006, ka qenë në shumën 2.450.000 lekë dhe 3.500 euro.

14.2.24. Lidhur me pretendimin se, *në fillim të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka pasur një gjendje të konsiderueshme likuiditeti të mbartur nga viti 2007, në shumën totale 7.079.887 lekë, ndërkohë ka krijuar edhe gjendje të reja gjatë vitit 2008, të cilat konfirmojnë dhe vërtetojnë burimet e ligjshme për mbulimin e pagesës së këstit të parë të çmimit të apartamentit, në shumën 62.000 euro, në tetor të vitit 2008*, trupi gjykues, në analizë të raportit financiar të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me ankimin, konstaton se, në fund të vitit 2007, likuiditetet janë llogaritur nga kontabilisti i miratuar, në total në vlerën 9.197.433 lekë, ndërkohë që referuar të njëjtit raport,³⁵ ai shprehet se: *duket qartë që në fillim të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka pasur një gjendje të konsiderueshme likuiditeti të mbartur nga viti 2007, në shumën totale 7.079.887 lekë*. Pra, në të njëjtin raport, i njëjti ekspert, pasqyron dy vlera të ndryshme likuiditetesh në fund të të njëjtit vit raportues. Në vlerësim të trupit gjykues, kjo ka ndodhur për shkak të efektit që jep në analizën e paraqitur prej tij, shtimi i kursimeve *cash* në shumën 2.225.107 lekë, *likuiditete të familjes së madhe para vitit 2003*, të pasqyruara si gjendje në analizën e vitit 2002, duke i mbartur ato deri në fund të vitit 2007, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar në *deklaratën e pasurisë 2003*, në deklaratat periodike në vijim apo në deklaratën e pasurisë *vetting*.

14.2.25. Sa sipër, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, ka kontrolluar analizën financiare të Komisionit në kuadër të verifikimit të mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të krijuar depozitën 35.000 euro, në janar të vitit 2007, duke përfshirë ndryshimin e gjendjes së likuiditetit në *cash*, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, pa përfshirë kursimet e pretenduara të prindërve të bashkëshortit, për sa arsyetuar më lart në këtë vendim. Rezultatet e kësaj analize konfirmuan balancën negative të konstatuar nga Komisioni në vendim, në shumën (-) 1.236.543 lekë.

14.2.26. Për shkakun ankimor, se *qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, për të ardhurat e babait të personit të lidhur si i dënuar politik, konfirmuar me shkresën nr. {***}, datë 02.03.2023, të Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, nga e cila rezultoi që babai i ndjerë i bashkëshortit kishte përfituar shumën në të holla 200.000 lekë dhe në masën 720.000 lekë në letra me vlerë, por nuk përcaktohet koha e përfitimeve, është i dyshimtë, jo i qartë dhe nuk specifikon asnjëherë nëse i mori apo jo në vlerësimin e tij këto shuma*, trupi gjykues, në analizë të vendimit objekt shqyrtimi, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, konstaton se Komisioni në vendim e ka arsyetuar qartë qëndrimin e tij lidhur me të dhënat e administruara nga ky institucion, pasi në shkresën e sipërcituar, institucioni përgjegjës shprehet se: *nga informacioni i përcjellë nga institucione të ndryshme rezulton se babai i bashkëshortit ka përfituar shumën në të holla në masën 200.000 lekë dhe në masën 720.000 lekë në letra me vlerë*, pa përcaktuar kohën e përfitimit të këtyre shumave. Në këto rrethana, trupi gjykues e çmon të drejtë vlerësimin e Komisionit për mospërfshirjen

³⁵ Faqe nr. 10 e tij, paragrafi i parë.

e tyre në analizë, për sa kohë nuk është provuar me dokumentacion, koha e përfitimit të këtyre shumave.

14.2.27. Lidhur me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, *se analiza e treguesve financiarë vërtetoi dhe konfirmoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi dhe burime financiare të ligjshme për mbulimin e pagesës së kështit të parë, në shumën 62.000 euro, më datë 17.10.2008*, trupi gjykues, në përmbledhje të konkluzioneve të arritura më sipër, se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka specifikuar burimet e krijimit të pasurisë “apartament” dhe “garazh” në rrugën “{***}”, Tiranë, por deklaron të gjitha të ardhurat e realizuara prej subjektit, personit të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur prej vitit 1989 e në vijim; (ii) nuk ka deklaruar kursimet e prindërve të personit të lidhur si burim krijimi të depozitës 35.000 euro, në datën 17.01.2007, përdorur për shlyerjen e kështit të parë të çmimit të apartamentit dhe garazhit më 17.10.2008, duke i pretenduar të tilla vetëm pasi u njoh me rezultatet e hetimit; (iii) për më tepër, nuk i ka deklaruar kursimet e pretenduara të prindërve të personit të lidhur në deklaratën e pasurisë 2003, apo në deklaratat periodike në vijim; (iv) nuk provoi mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortit për të krijuar kursimet në masën e pretenduar; (v) rezultoi me pamundësi financiare për krijimin e shtesës në kursime *cash*, në shumën 300.000 lekë, për vitin e mbyllur 2004; (vi) rezultoi me pamundësi financiare për krijimin e gjendjes së likuiditetit të pretenduar në fund të vitit 2007; (vii) kontrolli i analizës financiare të Komisionit në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së krijimit të depozitës 35.000 euro, më datë 17.01.2007, konfirmoi balancën negative të konstatuar prej tij në shumën (-) 1.236.543 lekë, për rrjedhojë të sa konkluduar më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë, në shumën 62.000 euro, në datën 17.10.2008, mbulimin e shpenzimeve të kryera dhe kursimeve të realizuara në këtë vit, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pagesën e kështit të dytë, në shumën 30.000 euro, në datën 20.03.2009

- 15.** Për pagesën e kështit të dytë të çmimit të apartamentit dhe garazhit në rrugën “{***}”, Tiranë, me burime të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, shumën 1.311.600 lekë, të tërhequra nga llogaria e nënës së subjektit të rivlerësimit, D. G., më datë 20.01.2009, dhe huan në shumën 20.000 euro, të marrë nga A. L., me kontratë huaje të datës 17.01.2009, Komisioni në vendim ka arritur në konkluzionin se: *personi tjetër i lidhur me cilësinë e huadhënësit nuk kishte burime financiare të ligjshme për dhënien hua të shumës 20.000 euro.*

15.1. Kundër konkluzioneve më sipër, subjekti i rivlerësimit ka ngritur në ankim këto pretendime: (i) Mbi kufijtë kohorë të shtrirjes së analizës financiare, duke referuar jurisprudencën e Kolegjit, konkretisht vendimin nr. 2/2023 (JR)³⁶. (ii) Vlerësimi i Komisionit në vendim, se mbajtja dhe shtimi në një periudhë të caktuar³⁷ i likuiditeteve *cash* në vlera të konsiderueshme nga subjekti dhe personi i

³⁶ Në vendimin nr. 2/2023 (JR), datë 02.02.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Elona Toro, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se: [...] 17.8 Kolegji, ashtu si edhe Komisioneri Publik, për sa i përket kufijve kohorë, në të cilën do të shtrihet analiza financiare për babanë e subjektit të rivlerësimit, për të verifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të shumave prej 6.000 euro dhe 4.000 USD, çmoi të drejtë kryerjen e saj duke filluar nga shkurti 2005 deri në momentin kur këto fonde janë kredituar përfundimisht në këto llogari, në nëntor 2008. Kolegji çmoi se versioni i analizës financiare, sipas pretendimit të subjektit për të konsideruar si kufij kohorë shkurtin e vitit 2005 deri në momentin që subjekti i kishte përfutur këto shuma, në korrik 2009, është një version, i cili nuk i përgjigjet kohës së krijimit të këtyre pasurive, por momentit të përdorimit të tyre si burim për financimin e pasurisë “apartament” në pronësi të subjektit. [...].

³⁷ Si në deklaratën e interesave private 2008, ashtu edhe në atë të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë të gjendjes *cash* në vlerat, përkatësisht 2.000.000 lekë dhe 1.200.000 lekë.

lidhur, nuk shkon me pretendimet e subjektit se qëllimi i marrjes së huave ka qenë pamundësia e likuidimit me të ardhurat e tyre të këstit/eve të shtëpisë, pasi të ndodhur në pamundësi financiare për likuidimin e këstit të dytë në afat, për të vijuar normalisht studimet e vajzave dhe jetesën familjare, subjekti dhe personi i lidhur vlerësuan të arsyeshme dhe të nevojshme marrjen e një huaje nga shtetasi A. L., në janar të vitit 2009. (iii) Komisioni duhet të kishte vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon burimet e të ardhurave të huadhënësit, sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, duke ndjekur standardin që ka aplikuar për pamundësinë objektive për njërin nga vëllezërit e subjektit në vendimin e tij. (iv) huadhënësi dhe personi i lidhur me të kanë realizuar të ardhura nga marrëdhënie punësimi që nga viti 2000, si dhe kanë pasur të ardhura nga aktiviteti bujqësor, të cilat nuk deklaroheshin sipas legjislacionit fiskal. Ngarkimi i subjektit me barrë prove edhe për këto vite është joproporcional. (v) Lëvizjet e llogarive bankare të vëna në dispozicion Komisionit, me të cilat u provua se huadhënësi dhe familjarët e tij kanë pasur lëvizje të konsiderueshme në bankë, të cilat kalojnë shumën e dhënë hua, dhe një rrethanë e tillë, në mënyrë të pakuptimtë, nuk u mor në konsideratë nga Komisioni. Në datën 24.09.2007, nga bashkëshortja e huadhënësit është tërhequr në llogarinë e përbashkët me babanë e tij, shuma prej 3.329.819 lekë, para dhënies së huas, shumë e cila ishte mbajtur *cash* dhe prej saj është konvertuar shuma prej 20.000 eurosh, dhënë më pas hua subjektit të rivlerësimit. (vi) Subjekti i rivlerësimit, duke referuar qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë,”³⁸ pretendon se, qartazi, standardi i ndjekur nga Komisioni, nuk është proporcional në këtë rast.

16. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore të Komisionit, në përgjigje të pretendimeve të subjektit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

16.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 105.13 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 24.41 m²”, në rrugën “{***}”, Tiranë: [...] edhe huat e marra ndaj personave të tretë, përkatësisht me kontratën e datës 17.01.2009, të datës 02.07.2010, si dhe atë të datës 01.03.2011.

Në rubrikën “Detyrime financiare [...]” të kësaj deklarate, subjekti deklaron: *Kontratë huaje, datë 17.01.2009, marrë me qëllim shlyerjen e detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes në shumën 20.000 euro, me afat trevjeçar, likuiduar shuma në vlerën 10.000 euro, në fund të vitit 2010, dhe kësti i dytë më datë 26.12.2012. Aktualisht shlyer tërësisht detyrimi. Konfirmuar përmes bursës së detyrimit me deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 25.01.2017.*

Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale [...]” të së njëjtës deklarate, subjekti deklaron: *Marrëdhënie huaje me shtetasin A. S. L. (huadhënësi), [...]. Burimet e huas: (i) kursime nga familje bujqësore, (ii) i punësuar privat dhe (iii) depozita bankare.*

16.2. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti ka depozituar: (i) Kontratë huaje, datë 17.01.2009, me huadhënësi A. L. dhe huamarrës L. M., bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, me objekt dhënien e shumës 20.000 euro hua, me afat 3-vjeçar, me interesin e depozitës që aplikon BKT-ja. Shuma e interesit do të llogaritet në shlyerjen përfundimtare të shumës së këstit të fundit, e cila do të jetë në varësi të aftësisë likuiduese të huamarrësit. (ii) Deklaratë e thjeshtë e A. L., datë 26.12.2012, në të cilën deklarohet se: *meqenëse nga huamarrësi më është likuiduar, më datë 26.12.2012, huaja në shumën 20.000 euro, brenda afatit, nuk i kam kërkuar interesin bankar, vetëm detyrimin.* (iii) Deklaratë noteriale, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017, e A. L., në të cilën deklarohet se:

³⁸ Shih paragrafët 88-93 të këtij vendimi.

me kursimet e mia ndër vite si familje bujqësore dhe i punësuar privat, si dhe depozita bankare, i kam dhënë shtetasit L. M., hua në shumën 20.000 euro. Shuma e dhënë hua më është kthyer nga huamarrësi në dy këste dhe konkretisht, kësti i parë në shumën 10.000 euro, më është kthyer në fund të vitit 2010, ndërsa kësti i dytë, në shumën 10.000 euro, më është kthyer më datë 26.12.2012. Në lidhje me interesat, ndryshe nga sa deklaruar në deklaratën e thjeshtë të vitit 2012, citohet se: *ka hequr dorë vullnetarisht, duke mos i kërkuar ato, për shkak të shërbimeve avokatore që më ka kryer mua dhe familjes time.*

16.3. Në deklaratën periodike vjetore 2009, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit deklaroi: *shlyer kredi në shumën 30.000 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 21.01.2009, me të ardhura nga llogaria e bashkëshortit prej 1.311.600 lekë, dhe kontratën e huas nr. {***}, datë 17.01.2009, me huadhënës A. L.* Në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *mbetur pa likuiduar kontrata e huas nr. {***}, datë 17.01.2009, shuma 50%, 10.000 euro.*

Në deklaratën periodike vjetore 2010, personi i lidhur me subjektin deklaroi: *shlyer huan e marrë nga huadhënësi A. L., në shumën 10.000 euro.* Në rubrikën “Detyrime financiare”, nuk deklaroi detyrim të mbetur ndaj huadhënësit A. L.

Në deklaratën periodike vjetore 2011, personi i lidhur me subjektin deklaroi: *mbartur detyrime sipas kontratave të huas së mëparshme, me z. P. H. dhe A. L., në shumat 5.000.000 lekë dhe 10.000 euro, përkatësisht.*

Në deklaratën periodike vjetore 2012, personi i lidhur me subjektin deklaroi: *shlyer detyrimi nga kontrata e huas datë 17.01.2009, në shumën 10.000 euro.*

Në deklaratat periodike vjetore 2010, 2011, 2012 dhe 2013, subjekti i rivlerësimit apo/dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar pakësim të gjendjes *cash* të viteve të mëparshme.

16.4. Me kontratë huaje datë 17.01.2009, shtetasi A. L. i ka dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. L. M., shumën 20.000 euro, me afat 3-vjeçar.

16.5. Gjatë hetimit në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagesat e bëra për shlyerjen e çmimit të apartamentit në vlerën 145.000 euro, mes të tjerash: [...], *paguar 30.000 euro, më datë 20.03.2009, me bankë [...].*³⁹

16.6. Në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit deklaroi marrëdhënien e huas me shtetasin A. L. (huadhënës) dhe burimet financiare të saj: (i) kursime si familje bujqësore, (ii) i punësuar privat dhe (iii) depozita bankare, duke bashkëlidhur dokumente shoqëruese në funksion të këtyre deklarimeve.⁴⁰

³⁹ Për të provuar këtë pagesë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kopje të dokumentit Njoftim Kreditimi, lëshuar nga ISP Bank ShA, më datë 20 mars 2009, për transaksionin e depozitimit *cash* të shumës 30.000 euro dhe transferimit të tyre më datë 21.03.2009, me përshkrimin: L. M. paguan për blerjen e apartamentit, kësti II. Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe lëvizjet e llogarive të përbashkëta të huadhënësit me personin e lidhur, në Bankën Kombëtare Tregtare ShA, në monedhën dollarë amerikanë dhe lekë.

⁴⁰ Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur: (i) Ekstrakt të QKB-së, person fizik me emër tregtar “A. L.”, NIPT {***}, datë regjistrimi 10.12.2008, objekt veprimtarie “Përpunim i ullirit dhe prodhimit të vajit”, ushtruar në Fushë - Krujë, Budull. Sipas ekstraktit, ky aktivitet rezulton me status çregjistruar sipas çështjes me numër {***}, datë 11.02.2009. (ii) Ekstrakt QKB-je, person juridik, “{***}.” ShPK, me NIPT {***}, datë regjistrimi 13.09.1999, ortak në shoqëri (administrator) A. L., me objekt veprimtarie “Tregtim i artikujve industrialë e ushqimorë, me shumicë e pakicë, import - eksport, si dhe i artikujve kozmetikë, bimë medicinale të ndryshme etj.”, të ushtruar në Tiranë, Fushë - Prezë; (iii) Pasuri e paluajtshme

16.7. Komisioni, në analizë të akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti person fizik “A. L.”, me NIPT {***}, është regjistruar në regjistrin tregtar më datë 10.12.2008, me objekt veprimtarie përpunimin e ullirit dhe prodhimin e vajit, në Fushë-Krujë. Ky subjekt tregtar rezulton i çregjistruar më datë 11.02.2009. Sa i përket subjektit shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar “{***}.”, me NIPT {***}, të regjistruar më datë 13.09.1999, me objekt aktiviteti tregti artikuj të ndryshëm, me ortakë fillestarë shtetasit A. H., A. P. dhe S. L., rezulton se A. L. është shtuar si ortak në këtë shoqëri me vendim të asamblesë së ortakëve datë 07.12.2015, pas largimit të dy ortakëve të tjerë, nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të babait, S. L., me dhurim. Sa sipër, deri në datën e dhënies së huas, A. L. nuk ka qenë ortak dhe/ose administrator i kësaj shoqërie.

16.8. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës (në vijim “DRT Durrës”) me shkresën nr. {***} prot., datë 16.09.2022, informon Komisionin se personi fizik “A. L.” rezulton i regjistruar më datë 10.12.2008 dhe i çregjistruar nga regjistri tregtar më datë 11.02.2009, dhe se nuk disponon informacion për qarkullim, fitim apo pagesë të detyrimeve tatimore.

16.9. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.09.2022, informon Komisionin se A. L. ka qenë i punësuar pranë punëdhënësit “N. H.”, Krujë, me NIPT {***}, prej vitit 2007 e në vijim, dhe pagat mbi të cilat janë derdhur kontributet për periudhën 2007 – janar 2009, rezultojnë në total në vlerën 383.000 lekë.

16.10. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive bankare në emër të D. ose A. L.,⁴¹ në Bankën Kombëtare Tregtare ShA, si dhe të llogarisë bankare të bashkëshortes së huadhënësit, në Union Bank ShA, Komisioni ka arsyetuar në vendim se huadhënësi A. L. (L.) ka pasur lëvizje në vlera monetare në llogaritë e tij bankare, përpara datës së dhënies së huas (vetëm në BKT, në vitin 2007, janë tërhequr nga llogaritë e sipërpërmendura shumat 3.650.000 lekë dhe 9.069 USD, të cilat rezultojnë më të larta se shuma e dhënë hua në janar të vitit 2009), por nuk është paraqitur dokumentacion për burimin e plotë të të ardhurave për krijimin e tyre.

16.11. Në kushtet që kjo hua nuk është dokumentuar me dokumentacion ligjor të kohës, si dhe nuk u provua burimi i të ardhurave të huadhënësit për dhënien e saj, Komisioni vlerësoi të mos e përfshijë atë në analizën financiare, e cila ka rezultuar me balancë negative në shumën (-) 2.497.862 lekë, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës me rezultatet e hetimit.

16.12. Lidhur me shlyerjen e huas, Komisioni ka konstatuar se në deklaratat periodike vjetore 2011, 2012 dhe 2013, nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur të kenë deklaruar ndryshim të gjendjes së likuiditeteve, shtesë apo pakësim të tyre, dhe se nuk kanë deklaruar burimet e shlyerjes së huas 20.000 euro, të marrë nga A. L., në deklaratën e pasurisë vetting apo në deklaratat periodike vjetore.

16.13. Në referim të procesverbalit të datës 06.12.2011, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se huaja ndaj shtetasit A. L. është shlyer nga kursimet cash të deklaruara.

në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, trull me sipërfaqe 1 900 m², ndërtesë 200 m², adresa “{***}”, Tiranë dhe Certifikatë për Vërtetim Pasurie, datë 06.02.2015; (iv) Pasuri e paluajtshme, regjistër hipotekor nr. {***}, datë 18.04.2017, regjistrim fillestar në vitin 1992, shtëpi banimi dykatëshe, kati përdhe 164 m², kati I e II - 170 m² dhe trull 200 m,² në Fushë - Krujë; (v) Depozita nga të ardhurat e bashkëshortes D. L., në Union Bank ShA.

⁴¹ Emrat e huadhënësit dhe të bashkëshortes së tij, sipas ekstraktit të lëvizjeve të llogarive bankare, depozituar në Komision nga vetë subjekti i rivlerësimit.

16.14. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep./kol., datë 25.01.2017⁴², huadhënësi A. L., deklaroi se: “[...]. Nga shuma e dhënë hua, më është kthyer nga huamarrësi L. M. [...], kësti i parë në shumën 10.000 euro, në fund të vitit 2010, ndërsa kësti i dytë, po në shumën 10.000 euro, më është kthyer më datë 26.12.2012”. Lidhur me shlyerjen e huas, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi në deklaratën periodike vjetore 2009: *mbetur pa likuiduar kontrata e huas nr. {***}, datë 17.01.2009, shuma 50%, 10.000 euro*. Në deklaratën periodike vjetore 2010 deklaroi: *shlyer huan e marrë nga huadhënësi A. L. në shumën 10.000 euro*, por jo pakësim të gjendjes *cash*, dhe në atë periodike vjetore 2011 deklaroi: *mbartur detyrime sipas kontratave të huas së mëparshme, me z. P. H. dhe A. L., në shumat 5.000.000 lekë dhe 10.000 euro, përkatësisht*. Ndërsa në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 21.04.2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *në vitin 2012, nuk kemi të ardhura cash, pasi janë likuiduar detyrime nga kontrata e huas së mëparshme ndaj z. L. (10.000 euro)*. Nga sa më sipër, Komisioni ka konstatuar mospërputhje në deklarime lidhur me kohën e shlyerjes të kësteve të huas.

16.15. Për rrjedhojë të sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar të mos pasqyrohet në analizën financiare edhe shlyerja e kësaj huaje, për të cilën si burim janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, kursimet në *cash*.

17. Në prapësime për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se si burim për pagesën e kështit të dytë të apartamentit dhe garazhit, në shumën 30.000 euro, më datë 20.03.2009, kanë shërbyer: (i) shuma e tërhequr nga llogaria e përbashkët e subjektit me nënën, D. G., në Intesa Sanpaolo Bank ShA, në shumën 1.311.600 lekë, më datë 20.01.2009 dhe (ii) huaja e marrë më datë 17.01.2009, në shumën 20.000 euro, nga A. L. Subjekti ka pretenduar se: (a) huadhënësi dhe familjarët e tij kanë gjeneruar të ardhura nga aktiviteti privat si familje bujqësore, pasi kanë përfituar tokë sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, si dhe nga punësimi në sektorin privat. Babai i huadhënësit ka qenë kryetar i familjes bujqësore dhe ka realizuar të ardhura nga kultivimi në këtë tokë bujqësore që prej vitit 1992 e në vijim, në vlerën rreth 1.500.000 – 2.500.000 lekë. (b) Huadhënësi ka qenë i punësuar te “N. H.” person fizik, nga viti 2000 deri në datën 24.02.2023. (c) Bashkëshortja e huadhënësit ka qenë e punësuar në BKT ShA, dega Fushë – Krujë, në periudhën 15.04.2004 – 12.07.2006 dhe në Union Bank ShA, në periudhën 01.01.2007 – 24.02.2023. (d) Nga nxjerrja e llogarisë bankare të datës 17.02.2023, në emër të S. ose D. L., rezulton të jetë tërhequr nga kjo e fundit, në datën 24.09.2007, shuma 3.329.819 lekë, para dhënies së huas, shumë e cila ishte mbajtur *cash* dhe prej saj është konvertuar shuma 20.000 euro e dhënë hua.

17.1. Lidhur me shlyerjen e huas, në prapësime për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka qenë pasaktësi e personit të lidhur në deklarimin e tij, në deklaratën periodike vjetore 2009, pasi kësti i parë prej 50% të vlerës është paguar në vitin 2010, me gjendjen *cash* që ka mbetur në vitin 2009 dhe të ardhurat e tremujorit të parë. Për të provuar deklaratat e saj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si prova me prapësimet, dokumentacion shkresor⁴³.

⁴² Përcjellë në Komision nga subjekti i rivlerësimit, me deklaratën e pasurisë vetting.

⁴³ Subjekti ka paraqitur si prova: (i) vërtetim, datë 24.02.2023, lëshuar nga punëdhënësi “N. H.” P. F., me të cilin provohet se: A. S. L. është punonjës pranë kësaj firme nga viti 2000 e në vazhdim, i paguhen rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; (ii) certifikatë regjistrimi prone me nr. pasurie {***}, z. k. {***}, arë sip. 22050 m², me adresë Tiranë, datë lëshimi 23.02.2022; (iii) kartela e pasurisë së paluajtshme z. k. {***}, lloji i pasurisë arë, nr. pasurie {***} dhe sip. 22050 m²; (iv) fragment i hartës kadastrale, z. k. {***}, nr. pasurie {***}, index i hartës; (v) certifikatë familjare, datë 22.02.2023, gjendje, datë 01.08.1991; (vi) nxjerrje llogarie, datë 17.02.2023, të llogarisë nr. {***} në ALL, në emër të S. ose D. L.j, datë 24.09.2000, faqe 1; (vii) nxjerrje llogarie, datë 15.06.2021 në USD, në emër të D. ose

18. Komisioni, në vlerësim të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit, ka arritur në konkluzionin se subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk kanë arritur të provojnë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve mbi barrën e provës të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit A. L., për shumën 20.000 euro, dhënë hua bashkëshortit të subjektit në janar të vitit 2009. Për sa më sipër, rezultoi se personi tjetër i lidhur me cilësinë e huadhënësit, A. L., nuk kishte burime financiare të ligjshme për dhënien hua të shumës 20.000 euro, shumë e cila është deklaruar se është përdorur për pagesën e këstit të dytë për blerjen e pasurisë “apartament” dhe “garazh”.
19. Në analizë të shkaqeve ankimore të subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues, bazuar në kuadrin ligjor të zbatueshëm, vlerëson se:

19.1. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *mbi kufijtë kohorë të shtrirjes së analizës financiare, në referim të jurisprudencës së Kolegjit, konkretisht vendimit nr. 2/2023 (JR)*, trupi gjykues vlerëson se subjektet e rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, kanë detyrimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratën *vetting*, në momentin kur është deklaruar dhe dokumentuar krijimi i tyre, dhe për rrjedhojë, deri në atë moment, duhet të analizohen edhe të dhënat financiare lidhur me burimet e deklaruara për krijimin e tyre. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mundësia financiare e huadhënësit për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën 20.000 euro, të deklaruar si burim për pagesën e këstit të dytë të apartamentit dhe garazhit, në rrugën “{***}”, Tiranë, duhet të analizohet deri në 17 janar 2009, kohë kur kjo shumë është deklaruar e dhënë hua personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit.

19.2. Sikurse parashikuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit së bashku me personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur me të, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, ngarkohen me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në kushtet që marrëdhëniet e huas mes A. L., në cilësinë e huadhënësit dhe personit të lidhur me subjektin, L. M., është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike të vitit 2009, në kuptim të kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të justifikojnë burimet e ligjshme të shumës së dhënë hua dhe, për rrjedhojë, të depozitojnë dokumentacion provues lidhur me burimet e të ardhurave, në masën e nevojshme për të përmbysur barrën e provës. Në këtë kuptim, ndryshe nga sa pretendon subjekti, hetimi i kryer nga Komisioni në zbatim të kësaj dispozite është në përputhje me ligjin dhe proporcional. Në vijim të këtij arsytimi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për efekt të këtij procesi, mbart detyrimin të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të krijimit të huas 20.000 euro, me burimet e deklaruara nga: (1) *familja bujqësore*, (2) *punësimi privat* dhe (3) *depozita bankare*.

19.2.1. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se huadhënësi ka krijuar të ardhura me burim nga familja bujqësore*, trupi gjykues vlerëson se fakti që familja e huadhënësit ka në pronësi tokë bujqësore, nuk legjitimon në kuptim të kuadrit ligjor të zbatueshëm krijimin e të ardhurave nga kjo pasuri. Subjekti i rivlerësimit, si në përgjigje të rezultateve të hetimit, ashtu dhe në shkaqet e ankimit, ka pretenduar se babai i huadhënësit ka qenë kryetar i familjes bujqësore, ka administruar dhe ka realizuar rreth 1.500.000 – 2.500.000 lekë të ardhura së bashku me pjesëtarët e tjerë, duke

A. L., për periudhën 15.04.2004 – 12.07.2006, f. 2; (viii) nxjerrje llogarie, datë 15.06.2021, të llogarisë në ALL, në emër të D. ose A. L., për periudhën 12.09.2005 – 05.01.2007, f. 3; (ix) nxjerrje llogarie, datë 24.02.2023, në ALL, në emër të D. L., për periudhën 01.01.2007 – 31.12.2010, f. 4.

kultivuar tokën bujqësore që nga viti 1992 e në vijim. Në kushtet që subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument për të provuar shfrytëzimin e kësaj pasurie/tokës bujqësore dhe realizimin e këtyre të ardhurave nga familja e huadhënësit, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit lidhur me këtë burim mbeten në nivel deklarativ.

19.2.2. Për të ardhurat e pretenduara nga *punësimi privat*, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, konstaton se: **(i)** Lidhur me aktivitetin që huadhënësi ka ushtruar si person fizik me emër tregtar “A. L.”, të regjistruar më 10.12.2008, me NIPT {***}, dhe objekt aktiviteti “Përpunim i ullirit dhe prodhimi i vajit”, të ushtruar në Fushë-Krujë, Budull, nga organet tatimore nuk konfirmohet informacion mbi qarkullimin, fitimin apo pagesën e detyrimeve tatimore. Ky shtetas nuk rezulton i regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, apo në përgjegjësinë tatim në burim, për efekt qiradhënie. **(ii)** Sa i përket aktivitetit që huadhënësi ka ushtruar si ortak i vetëm i shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, të regjistruar më datë 13.09.1999, me NIPT {***}, me objekt veprimtarie *tregtim i artikujve industrialë e ushqimorë, me shumicë e pakicë, import - eksport, si dhe i artikujve kozmetikë, bimë medicinale të ndryshme etj.*, të ushtruar në Tiranë, Fushë - Prezë, nga aktet rezultoi se huaja është dhënë më 17.01.2009, pra përpara se huadhënësi të bëhej ortak i vetëm i shoqërisë. **(iii)** Të ardhurat e deklaruara me burim nga punësimi në sektorin privat të huadhënësit, pranë subjektit tregtar “N. H.”, regjistruar me NIPT {***}, për periudhën 2007 – janar 2009, në shumën 383.000 lekë, janë ndjeshëm larg të qenët të konsiderueshme për të provuar mundësinë e huadhënësit që me to të mbulojë shpenzimet e jetesës dhe të japë hua shumën 20.000 euro, në datën 17.01.2009, personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, me provat e depozituara në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë që të ardhurat nga punësimi privat të kenë shërbyer si burim për huan e dhënë.

19.2.3. Sa i përket shkakut të ankimit të subjektit, *se nuk qëndron vlerësimi i Komisionit se mbajtja dhe shtimi në një periudhë të caktuar i likuiditeteve cash në vlera të konsiderueshme nga subjekti dhe personi i lidhur, nuk shkon me pretendimet e subjektit se qëllimi i marrjes së huave ka qenë pamundësia e likuidimit me të ardhurat e tyre të kështit/eve të shtëpisë, pasi të ndodhur në pamundësi financiare për likuidimin e kështit të dytë në afat dhe vijuar normalisht studimet e vajzave e jetesën familjare, vlerësuan të arsyeshme dhe të nevojshme, marrjen e një huaje nga shtetasi A. L., në janar të vitit 2009*, trupi gjykues vlerëson se ky arsyetim i Komisionit lidhet me besueshmërinë e deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, në rrethana të tilla që ka rezultuar nga aktet, shtim i gjendjes *cash* në vlerat 2.000.000 lekë, të deklaruara në deklaratën periodike vjetore 2008, dhe 1.200.000 lekë në atë të vitit 2009, dhe jo si një konkluzion përcaktues në kuadër të vlerësimit të marrëdhënies së huas.

19.2.4. Për pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se lëvizjet e llogarive bankare të vëna në dispozicion Komisionit, me të cilat u provua se huadhënësi dhe familjarët e tij kanë pasur lëvizje të konsiderueshme në bankë, të cilat kalojnë shumën e dhënë hua, dhe një rrethanë e tillë, në mënyrë të pakuptimtë, nuk u mor në konsideratë nga Komisioni*, trupi gjykues vlerëson se, për efekt të këtij procesi, organet e rivlerësimit nuk mund të ndalen vetëm në verifikimin e disponimit të likuiditeteve të huadhënësit/ve në bankë, pa verifikuar burimin dhe ligjshmërinë e krijimit të tyre. Për sa kohë huadhënësit janë kualifikuar si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të provuar mundësinë financiare të huadhënësve, që me të ardhura të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të krijojnë shumat e dhëna hua. Për të provuar

mundësinë financiare të huadhënësit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës nxjerrjet e llogarisë bankare dyemërore, të babait dhe të bashkëshortes së tij, në Bankën Kombëtare Tregtare ShA, nga e cila rezulton se, deri më datë 24.09.2007, para dhënies së huas, është tërhequr shuma 3.329.819 lekë⁴⁴, e cila është mbajtur *cash* dhe është konvertuar më pas në shumën 20.000 euro, të dhënë hua. Nisur nga fakti që kanë kaluar gati dy vjet nga data e tërheqjes së shumës 3.329.819 lekë, deri në datën e dhënies së huas, në janar të vitit 2009, si dhe mungesa e dokumentacionit provues në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë dhe destinacionit të përdorimit të saj, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të konkludohet *a priori* që huaja e dhënë nga A. L., më datë 17.01.2009, në shumën 20.000 euro, e ka burimin nga kjo llogari. Për më tepër, nga aktet në dosjen gjyqësore të Komisionit, nuk rezulton që transaksionet e huadhënies të jenë kanalizuar nëpërmjet llogarive bankare. Pavarësisht se nuk ka qenë detyrim ligjor, në vlerësim të trupit gjykues, vetë subjekti i rivlerësimit duhet të ishte i interesuar për kryerjen me transparencë të veprimeve financiare, për të mundësuar provueshmërinë dhe lehtësuar gjurmueshmërinë e tyre, në kushtet që ka qenë subjekt deklarimi. Për gjithë sa më sipër argumentuar, pretendimi i subjektit të rivlerësimit u gjet i pabazuar.

Lidhur me shkakun ankimor, *se Komisioni duhet të kishte vlerësuar që subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin, i cili justifikon burimet e të ardhurave të huadhënësit, sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, duke ndjekur standardin që ka aplikuar për pamundësinë objektive për njërin nga vëllezërit e subjektit në vendimin e tij*, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, vlerëson se në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të vërtetuar zhdukjen apo humbjen e dokumentacionit justifikues sipas dispozitës më sipër, por të ardhurat e dokumentuara të huadhënësit janë të pamjaftueshme për të justifikuar shumën 20.000 euro, të dhënë hua në vitin 2009, dhe pretendimet e subjektit mbi burimin e krijimit të huas mbetën në nivel deklarativ e nuk arritën nivelin e besueshmërisë. Këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit e ka ngritur për të tria huat e deklaruara si burim për shlyerjen e kësteve të apartamentit dhe garazhit objekt shqyrtimi. Dokumentacioni, për të tri huat, si ai i vënë në dispozicion nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe ai i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se nuk ka provuar mundësinë financiare të huadhënësve për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shumën e dhëna hua, ndryshe nga rasti i vëllait, sjellë në vëmendje nga ana e subjektit, për të cilin është provuar me dokumentacion marrëdhënia e punësimit dhe qëndrimi i vëllait në emigracion për periudhën pas vitit 2011. Sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit u gjetën nga trupi gjykues të pabazuara.

19.2.5. Subjekti i rivlerësimit, duke referuar qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”⁴⁵, pretendon se, *qartazi, standardi i ndjekur nga Komisioni, nuk është proporcional në këtë rast*. Rrethanat faktike dhe situatat ligjore, të sjella në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, në vlerësim të trupit gjykues janë tërësisht të ndryshme nga ato të rezultuara në rastin konkret. Për këtë arsye dhe sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.

19.2.6. Në përfundim, lidhur me pagesën e kështit të dytë, në shumën 30.000 euro, në datën 20.03.2009, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provuan mundësinë financiare të huadhënësit A. L., për dhënien e huas në shumën 20.000 euro, në janar të vitit 2009, duke rezultuar kështu me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për likuidimin e këtij

⁴⁴ Ky veprim bankar është kryer nga bashkëshortja, D. L., në llogarinë e përbashkët me babain e personit tjetër të lidhur.

⁴⁵ Paragrafët 88 - 93 të këtij vendimi.

kësti, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pagesën e kështit të tretë, në shumën 30.000 euro, në datën 02.07.2010

20. Për pagesën e kështit të tretë të çmimit të apartamentit dhe garazhit, në rrugën “{***}”, Tiranë, me burim të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, huan në shumën 5.000.000 lekë, të marrë nga P. H., me kontratë huaje nr. {***} regj., datë 02.07.2010, Komisioni në vendim ka arritur në konkluzionin se: *subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të barrës së provës në rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit P. H., për shumën 5.000.000 lekë, dhënë hua bashkëshortit të subjektit me kontratë, në datën 02.07.2010, [...] shumë e cila është deklaruar se është përdorur për pagesën e kështit të tretë për blerjen e pasurisë “apartament” + “garazh”.*

20.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këto konkluzione të Komisionit, duke pretenduar: **(i)** Në lidhje me shumën 5.000.000 lekë të marrë hua, nga ana e subjektit u paraqitën një sërë dokumentesh,⁴⁶ të cilat nuk u konsideruan të mjaftueshme nga Komisioni për të vërtetuar mundësinë financiare të huadhënësit P. H. **(ii)** Duke ballafaquar provat e paraqitura nga subjekti me vetë praktikën e Kolegjit në vendimin nr. 2/2023 (JR),⁴⁷ këto konkluzione nuk qëndrojnë, pasi në rastin konkret rezultojnë që

⁴⁶ **(i)** Ekstraktin nga QKB-ja, person fizik me NIPT {***}. -- **(ii)** Dokumentacionin për pasuri të paluajtshme, në Fushë - Krujë dhe Krujë. -- **(iii)** Kontratë qiraje, datë 27.03.2004, sipas së cilës shtetasi P. H. ka dhënë me qira ambientin me sipërfaqe 15 m², për periudhën 01.04.2004 – 01.04.2005, kundrejt qirasë 25.000 lekë/muaj. Shuma prej 300.000 lekësh është paguar me lidhjen e kontratës. -- **(iv)** kontratë qiraje, datë 20.09.2006, sipas së cilës shtetasi P. H. ka dhënë me qira ambientin me sipërfaqe 15 m², për periudhën 01.10.2006 – 30.09.2008, me të drejtë përsëritje, kundrejt qirasë 25.000 lekë/në muaj. Referuar kësaj kontrate, shuma e të ardhurave të përfituara ka qenë 600.000 lekë. -- **(v)** Dokumentacion mbi llogari bankare në USD, në Credins Bank, e hapur në datën 31.03.2004. -- **(vi)** dokumentacion mbi llogari bankare në lekë dhe USD, në Raiffeisen Bank. -- Kontratë qiraje, datë 10.12.2011, referuar së cilës shtetasi P. H. ka dhënë me qira ambientin me sipërfaqe 86 m², kundrejt qirasë 50.000 lekë/muaj, për një periudhë njëvjeçare, me të drejtë rizgjatje. -- Përmbledhje e taksave dhe udhëzimeve për paraqitjen e Deklaratës Federale të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale, viti 2005, në shumën 8.900 USD; -- Përmbledhje e taksave dhe udhëzimeve për paraqitjen e Deklaratës Federale të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale, viti 2006, në shumën 5.998 USD; -- Përmbledhje e taksave dhe udhëzimeve për paraqitjen e Deklaratës Federale të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale, viti 2007, në shumën 9.466 USD; -- Certifikatat familjare nr. {***}, nr. {***} dhe nr. {***}, të tria të datës 24.02.2023; -- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.09.2022; -- Deklaratë (me shkresë të thjeshtë), datë 31.12.2015, për shlyerje të huas, në shumën prej 1.500.000 lekë, në emër të P. Sh. H.; -- Depozitim në llogari, datë 31.10.2019, për shlyerje të huas datë 02.07.2010, në shumën 1.000.000 lekë, në emër të P. Sh. H.; -- Depozitim në llogari (transfer të bankare), datë 14.12.2020, në shumën 1.000.000 lekë, për shlyerje të huas datë 02.07.2010, në emër të P. Sh. H.; -- Depozitim në llogari (transfer të bankare) datë 17.12.2021, në shumën 1.500.000 lekë, për shlyerje të huas datë 02.07.2010, në emër të P. Sh. H.; -- Certifikatë vdekjeje nr. {***}, datë 29.3.2016, faqe 1; -- Vërtetim dhe verifikim i dokumentacionit me postë elektronike, të ardhur në adresën e email-it {***}, nga dërguesi {***}, datë 03.03.2023, ora 15:15; -- “Deklaratë personale”, me shkrim dore, nga P. H., e nënshkruar më datë 02.02.2023 (bashkëngjitur).

⁴⁷ 18.7 - [...], Kolegji vëren se, edhe në rastin e analizës, për këtë person tjetër të lidhur rezultojnë disa të ardhura të dokumentuara të krijuara prej tij dhe familjes së tij, por edhe **një sërë të ardhurash të tjetra të pretenduara, që vijnë si nga administrimi i ish-pronave të kthyer babait të tij e bashkëpronarëve**, ashtu edhe nga aktiviteti tregtar që ky person ka zhvilluar në vite si aksionar në disa shoqëri, kuotat e të cilave i ka shitur më pas. **Ky aktivitet ka zgjatur në kohë dhe kjo situatë komplekse financiare, nëse do t’i nënshtrohej verifikimit e kontrollit me të njëjtën metodologji, sikurse të ardhurat e dhëna hua, do të rëndonte në mënyrë disproporcionale subjektin e rivlerësimit, i cili do të duhej të mbante një barrë prove të rëndë e të padrejtë për llogari të procesit të saj të rivlerësimit. [...].**

18.21 - Kolegji, pasi vlerësoi këtë rezultat financiar, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke pasur në konsideratë një sërë faktorësh që shoqërojnë situatën e personit tjetër të lidhur, si: (i) ekzistencën e disa burimeve që kanë mundësuar krijimin e të ardhurave në vite, të cilat janë deklaruar sipas vlerësimit të vetë personit tjetër të lidhur; (ii) të drejtat pasurore mbi pasuri të paluajtshme, të cilat duket se kanë prodhuar të ardhura ndër vite; (iii) shumat monetare të depozituara në llogari bankare në vlera më të mëdha se ato të dhëna hua, kohë para kryerjes së këtij transaksioni; (iv) pamundësinë së subjektit të rivlerësimit për të provuar saktësisht normën e fitimit të personit tjetër të lidhur në kushtet e llojit të veprimtarisë që ai kryente; (v) gabime të mundshme në përlllogaritje, duke qenë se personat, pasuria e të cilave është marrë në analizë, nuk kanë qenë ndonjëherë mbartës të ndonjë detyrimi për deklarim, si edhe në

huadhënësi ka pasur aktivitete të shtrira në kohë, të cilat nuk deklaroheshin në një format të detajuar në vitet 1991–1998. Të kërkuar nga subjekti të provohet i gjithë aktiviteti i huadhënësit, që nga viti 1984 deri në dhënien e huas, duke ia ngarkuar asaj barrën e provës edhe për këto vite, periudhë e largët për të cilën nuk parashikohej detyrimi për deklarim, është joproporcionale. **(iii)** Bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, detyrimin për të paguar tatimin në burim e kishin qiramarrësit, të cilët ushtronin aktivitetin në premisat në pronësi të huadhënësit. Bazuar në legjislacionin e kohës, biznesi i vogël nuk dorëzonte raporte financiare në tatime. Vetëm me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 32, datë 31.12.2013, të miratuar në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, u bë i detyrueshëm dorëzimi i bilanceve të thjeshtuara për këto kategori aktivitete. Duhet theksuar se aktiviteti i fundit që ka kryer huadhënësi është në vitin 2006, pra ky detyrim nuk shtrihej për të. **(iv)** Për huadhënësin, edhe pse kishte dërguar të dhënat e të ardhurave të deklaruara në ShBA dhe numrat e llogarive bankare për të provuar të kundërtën e barrës së provës, subjekti paraqet si prova shkresore, edhe nxjerrje të llogarive bankare të tij. Lëvizjet e shumave në këto llogari plotësojnë një nga kriteret që ka përcaktuar Kolegji në jurisprudencën e tij, që tregon për një aktivitet të ligjshëm të huadhënësit, për më tepër, të realizuar në emigracion. Nga ana tjetër, vetë Komisioni ka pranuar që ka pasur lëvizje të konsiderueshme në bankë dhe shumat e depozituara tejkalojnë shumën e dhënë hua, e duke qenë ky një kriter vlerësimi, është e pakuptimtë, përse nuk u mor në konsideratë. Legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave i detyronte bankat që të raportonin çdo lëvizje shumash mbi 1.5 milionë lekë. Në këtë aspekt, nuk ka pasur asnjë lloj kontrolli, pra këto para asnjëherë nuk kanë qenë të dyshimta. **(v)** Duke sjellë në vëmendje vendimin e GjEDNj-së në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, paragrafët 88, 90-93, subjekti pretendon se në këtë rast diskutohen të ardhurat e krijuara në emigracion nga ana e huadhënësit për periudha para procesit të rivlerësimit kalimtar, por standardi që ka ndjekur Komisioni nuk është proporcional në rastin konkret. **(vi)** Në lidhje me kontratat e huas, subjekti i rivlerësimit pretendon se janë lidhur në kushtet e lirisë kontraktuale dhe të mirëbesimit mes palëve, në një marrëdhënie detyrimi, huadhënësit janë persona të njohur për ne prej vitesh dhe marrëdhëniet me ta janë ekzistuese, gjë që konfirmohet edhe me dokumentet që kemi sjellë, dhe se na janë përgjigjur për çdo kërkesë tonën në raport me procesin. Nga ana tjetër kemi hyrë në marrëdhënie detyrimi, duke qenë tejskajshëm të kujdesshëm me persona që janë korrektë, pa asnjë precedent penal dhe pa asnjë konflikt interesi.

21. Në analizë të shkaqeve ankimore të subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosjen gjyqësore, konstaton dhe vlerëson se:

21.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, rubrika “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: “Marrëdhënia e huas me shtetasin P. SH. H. (huadhënës/shok i bashkëshortit), kontratë huaje datë 02.07.2010”, me burime: “(i) të ardhura nga puna në emigracion; (ii) të ardhura nga dhënia me qira e pasurive të paluajtshme (dyqane në Fushë - Krujë dhe apartament në Krujë)”. Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, të kësaj deklarate, personi i lidhur me subjektin deklaroi: “Kontratë huaje nr. {***} regj., datë 02.07.2010, marrë hua me qëllim shlyerjen e detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes në shumën 5.000.000 lekë pa afat, likuiduar pjesërisht në shumën 1.500.000 lekë, më datë 31.12.2015. Deklaratë konfirmuese e datës 31.12.2015 e

mungesë të ndonjë indicie që e bënte të pabesueshme ekzistencën e marrëdhënies së huas, arriti në konkluzionin se, në vlerësimin e përgjithshëm të të gjitha këtyre rrethanave, balanca negative e konstatuar nuk do të konsiderohet si përcaktuese për provueshmërinë e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 45.000 eurosh dhe ajo do të konsiderohet se e kalon testin e parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

huadhënësit”. Bashkëlidhur janë paraqitur aktet: (i) Kontratë huaje, nr. {***} regj., më datë 02.07.2010, mes huadhënësit P. H. dhe huamarrësit L. M., me objekt: *dhënie hua të shumës 5.000.000 lekë, pa afat, me interesin e depozitës që aplikon Raiffeisen Bank ShA.* (ii) Deklaratë me shkrim dore, më datë 31.12.2015, në të cilën huadhënësi P. H. deklaroi se, *në këtë datë, i është paguar nga huamarrësi shuma 1.500.000 lekë, detyrim që rrjedh nga kontrata e huas nr. {***}, regjistri, datë 02.03.2010.*⁴⁸

21.2. Në deklaraten periodike vjetore 2010, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Shlyer kësti i blerjes së apartamentit më datë 02.07.2010, te firma ‘{***}’, me të ardhurat e marra hua, kontrata e datës 02.07.2010, huadhënës P. H.*”. Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë e fizikë” të saj, personi i lidhur deklaroi: [...], *kontrata e huas datë 02.07.2010, me kredidhënës z. P. H., detyrim i mbetur 5.000.000 lekë.*

21.3. Në deklaraten periodike vjetore 2015, rubrika “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, personi i lidhur deklaroi: “*Kontrata e huas e datës 02.07.2010, depozituar në deklarimet e mëparshme, shlyer gjatë vitit shuma 1.500.000 lekë, detyrimi i mbetur pa shlyer 3.500.000 lekë*”.

21.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁴⁹, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se huadhënësi P. H., si burim huaje ka përdorur: (i) *të ardhura nga puna në Shqipëri, pasi ka ushtruar biznesin si fotograf, në Fushë - Krujë, për periudhën 1992 – 2004;* (ii) *të ardhura nga emigracioni në punë të ndryshme;* (iii) *të ardhura nga dhënia me qira të pasurive të paluajtshme, si edhe (iv) nga llogaria bankare në lekë/euro pranë RZB ShA, Krujë, dhe Banka Credins ShA, dega Tiranë, nga viti 2004 e në vijim.* Bashkëlidhur këtij pyetësori, subjekti, ndër të tjera,⁵⁰ ka paraqitur:

- Dokumentacion, nëpërmjet të cilit provon se, më datë 02.07.2010, është paguar me depozitim *cash* shuma 30.000 euro në Intesa Sanpaolo Bank ShA, me përshkrimin: “*L. M. këst për blerje apartamenti*”.

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep./{***} kol., datë 10.04.2017, në të cilën P. H. deklaroi si burim për huan: (i) *të ardhurat nga biznesi që ka ushtruar në Shqipëri;* (ii) *të ardhura nga qiratë;* (iii) *të ardhurat nga puna si emigrant i ligjshëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndër vite (në vijim “ShBA”).* Huadhënësi deklaroi gjithashtu se nga shuma e dhënë hua i është kthyer nga huamarrësi, shuma 1.500.000 lekë, në datën 31.12.2015. Diferenca mbetet për t’u paguar në kohët në vijim.

- Kontratë qiraje nr. {***} rep./{***} kol., datë 27.03.2004, sipas së cilës P. H. lëshon me qira 25.000 lekë në muaj një ambient në pronësi të tij, me sipërfaqe 15 m², për periudhën 01.04.2004 – 04.04.2005. Me lidhjen e kontratës i është paguar shuma 300.000 lekë.

⁴⁸ Data e dhënies së huas, cituar në deklaraten e dorës, nuk përputhet me datën e deklaratës pranë zyrës së avokatisë.

⁴⁹ Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimin e të ardhurave ndër vite përdorur për dhënie hua: -- (i) *ka ushtruar aktivitetin e biznesit, si fotograf në Fushë-Krujë, nga data 06.01.1993, si person fizik me NIPT {***};* (ii) *nga “njësi”, e cila është dhënë me qira që nga viti 2004 e në vijim me qiramarrës të ndryshëm. Pasuri “apartament”, Fushë - Krujë, lagja “{***}”, kati i parë, me sipërfaqe 35 m²;* (iii) *nga pasuria nr. {***}, me sipërfaqe 31.2 m², dhënë me qira nga data 27.03.2004, me qiramarrës Union Bank ShA, pas vitit 2004 e në vijim;* (iv) *apartament në z. k. {***}, lagja nr. {***}, Krujë, me sipërfaqe 38.30 m², i cili që prej datës 01.11.2005 e në vijim, i është dhënë me qira shtetasit Ç. S., që banon edhe aktualisht me qira;* (v) *ka llogari rrjedhëse, depozitë në lekë pranë Raiffeisen Bank dhe në dollarë;* (vi) *nga viti 2004 ka emigruar në ShBA, ku jeton aktualisht, në adresën: {***} st. {***}, NY {***} U.S.A. dhe punon në Quality Business Services, me detyrë shërbim roje, sipas deklaratës së fitimeve. Ka punuar te D. C. P., në adresën: 414 3TH Avenue Brooklyn, New York, në periudhën 2007 – 2009. Ka punuar gjithashtu te D. C. P., adresa: 37 Avenue, 11 Street Astoria, New York, në periudhën 2007 – 2009, si hidraulik.*

⁵⁰ Subjekti ka bashkëlidhur: (i) - Ekstrakt QKB, person fizik me NIPT {***}; (ii) - dokumentacion për pasuri të paluajtshme në Fushë - Krujë dhe Krujë; (iii) - dokumentacion mbi llogari bankare në USD, në Credins Bank, e hapur në datën 31.03.2004; (iv) - dokumentacion mbi llogari bankare në lekë dhe USD në Raiffeisen Bank.

- Kontratë qiraje nr. {***} rep./{***} kol., datë 20.09.2006, sipas së cilës P. H. lëshon me qira 25.000 lekë në muaj, një ambient në pronësi të tij me sipërfaqe 31.2 m², për periudhën 01.10.2006 – 30.09.2008. Referuar kësaj kontrate, shuma e të ardhurave të përfituara ka qenë në vlerën 600.000 lekë, deri në shtator 2008.
- Deklaratë e fitimeve (*statement of earnings*), datë 11.09.2020, mbi të ardhurat nga puna e huadhënësit P. H., si shërbim roje, në ShBA.

21.5. Sa më sipër ka rezultuar se të ardhurat nga qiraja deri në periudhën e dhënies së huas, më datë 02.07.2010, rezultojnë në shumën 900.000 lekë. Nga të dhënat e lëvizjeve të llogarive bankare në emër të huadhënësit P. H., depozituar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se, më datë 28.05.2010, është kredituar llogaria e huadhënësit në Raiffeisen Bank ShA, me shumën 60.000 USD, e cila është tërhequr më datë 16.06.2010, është konvertuar në 6.672.000 lekë e më pas është transferuar në llogarinë e këtij shtetasi në të njëjtën bankë, në monedhën *lekë*. Mbajtësi i llogarisë, P. H., e ka investuar këtë shumë, më datë 21.06.2010, në depozitë me afat 12-mujor. Në këto kushte, huadhënësi rezulton me gjendje likuiditetesh, por në pamundësi për përdorimin e tyre, pasi depozita është maturuar më datë 21.06.2011. Përpos sa sipër, referuar kopje *marrëveshje depozitë me afat*, me Credins Bank ShA, depozituar nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, rezulton që huadhënësi P. H. ka çelur depozitë në shumën 21.000 USD në këtë bankë, më datë 31.03.2004, me afat maturimi më datë 31.03.2005, e rinovuar, dhe sipas dokumentit të disponuar, librezë depozite, gjendja e saj më datë 30.03.2013, ka qenë 26.937,16 USD.

21.6. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, me shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 23.09.2022, informon Komisionin se: “[...] P. H. rezulton i regjistruar në DRT Durrës, me NIPT {***}, për të ushtruar aktivitetet në fushën e ‘aktiviteteve fotografike’, në adresën: Fushë - Krujë, nga data 12.10.2006 dhe aktualisht është në statusin pasiv nga data 30.12.2012. Ky tatimpagues nuk ka deklaruar të dhëna në sistemin C@ts. P. H. rezulton i regjistruar në DRT Durrës, Agjencia Krujë, me NIPT {***}, me objekt në ‘fushën e arsimit për sporte dhe argëtim’, në adresën Krujë, nga data 04.04.2003 dhe aktualisht është në statusin pasiv nga data 30.12.2012. Ky tatimpagues nuk ka deklaruar të dhëna në sistemin C@ts. Gjithashtu, ky institucion sqaron se nga të dhënat e verifikuara në dosjen e tatimpaguesit P. SH. H., tatimpaguesi ka kryer aktivitet si fotograf për vitet 1993 – 1999, 2001, 2003, 2006. Në periudhat nga viti 1993 deri në prill të vitit 2009, të dhënat e ish - Degës së Tatim Taksave Krujë kanë qenë manuale dhe jashtë sistemit informatik tatimor”.

21.7. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Arkivi, Bashkia Krujë, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.09.2022, informon Komisionin se nuk disponon të dhëna për pasuri të deklaruara të dhëna me qira për aktivitet tregtar për/nga shtetasi P. H.

21.8. Lidhur me burimet e të ardhurave të huadhënësit, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] huadhënësi ka pasur të ardhura në cash rreth 2.600.000 lekë dhe për të plotësuar pjesën e mbetur prej 2.400.000 lekësh u ka kërkuar dy nipërve të bashkëshortes së tij, shtetasve S. S. dhe A. S., që të mundësojnë plotësimin e shumës. Nga ana e tyre janë tërhequr në Union Bank më datë 02.07.2010, shuma 1.192.792 lekë, nga shtetasi S. S. dhe 1.251.004 lekë, nga shtetasi A. S. Për të provuar sa sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***} rep./{***} kol., datë 30.11.2022, të deklaruesve S. dhe A. S., në të cilën deklarojnë se, nga halla e tyre, L. H. (S.), u është dhënë shuma prej 24.000 USD, kursime nga puna e saj, që janë depozituar në Union Bank, Dega Fushë-Krujë, në llogaritë përkatëse në emër të A. dhe S. S. Me kërkesë të hallës dhe të bashkëshortit i kemi tërhequr kursimet e saj, pasi do t’ia jepnin hua shokut të ngushtë, L. M.

21.9. Për të provuar të ardhurat e huadhënësit nga emigracioni, subjekti ka depozituar deklaratat e tatimit mbi të ardhurat në ShBA për vitin 2008, në shumën bruto 23.226 USD, për vitin 2009, në shumën 29.797 USD dhe për vitin 2010, në shumën 38.632 USD, pra në total, shuma e të ardhurave të realizuara nga huadhënësi dhe bashkëshortja e tij, për periudhën 2008 – 2010, rezultojnë në vlerë bruto 91.655 USD.

21.10. Lidhur me këtë hua, nga Komisioni është vlerësuar se nuk u dokumentua me dokumentacion ligjor të kohës, si dhe nuk u provua burimi i të ardhurave të huadhënësit për dhënien e saj. Subjekti duket se ka ndryshuar deklaram lidhur me burimin e kësaj huadhënieje, duke përfshirë edhe shtetasit S. S dhe A. S. Subjekti nuk ka provuar dhe dokumentuar mënyrën e dhënies së kësaj huaje nga P. H. Për këto arsye, Komisioni vendosi të mos përfshihet kjo hua në analizën financiare paraprake, si dhe këstet e deklaruara për shlyerjen e saj.

Nga analiza paraprake financiare për pagesën e shumës prej 30.000 euro, më datë 02.07.2010, si dhe mbulimin e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 01.01.2010 – 02.07.2010, Komisionit i ka rezultuar balancë negative në shumën (-) 3.933.792 lekë, për të cilën i kaloi subjektit barrën e provës.

21.11. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se si burim për pagesën e kështit të tretë, në shumën 30.000 euro, më datë 02.07.2010, ka qenë shuma e marrë hua nga P. H. sipas kontratës së huas lidhur në të njëjtën datë, në shumën 5.000.000 lekë, nga e cila, shumën prej 2.556.204 lekë, huadhënësi e ka pasur gjendje *cash* dhe pjesën tjetër e ka plotësuar me kursimet e bashkëshortes, të depozituara në llogaritë bankare të dy nipave të saj, S. dhe A. S., në Union Bank ShA, Dega Fushë - Krujë.⁵¹

21.12. Në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, Komisionit i ka rezultuar se të ardhurat e huadhënësit dhe të bashkëshortes së tij, nga punësimi në ShBA, për periudhën 2005 – 2007, në shumën 24.364 USD, kanë qenë më të ulëta se shpenzimet e jetesës, në shumën 39.462 USD,⁵² pa përfshirë shpenzime qiraje. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur nuk kanë arritur të provojnë me dokumentacion provues të kundërtën e konstatimeve të barrës së provës, lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit P. H., për krijimin e shumës 5.000.000 lekë dhënë hua personit të lidhur me subjektin, më datë 02.07.2010.

21.13. Në përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të ngritura në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit, vlerëson se:

⁵¹ Subjekti ka bashkëlidhur përgjigjes së tij dhe këto akte: (i) përmbledhje e taksave dhe udhëzime për paraqitjen e Deklaratës Federale të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale, viti 2005, në shumën 8.900 USD; (ii) përmbledhje e taksave dhe udhëzime për paraqitjen e Deklaratës Federale të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale, viti 2006, në shumën 5.998 USD; (iii) përmbledhje e taksave dhe udhëzime për paraqitjen e Deklaratës Federale të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale, viti 2007, në shumën 9.466 USD; (iv) certifikatë familjare, datë 24.02.2023; (v) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.09.2022; (vi) deklaratë (me shkresë të thjeshtë), datë 31.12.2015, për shlyerje të huas në shumën prej 1.500.000 lekë, në emër të P. H.; (vii) depozitim në llogari, më datë 31.10.2019, për shlyerje të huas datë 02.07.2010, në shumën 1.000.000 lekë, në emër të P. H.; (viii) depozitim në llogari (transferte bankare), datë 14.12.2020, në shumën 1.000.000 lekë për shlyerje të huas, datë 2.7.2010, në emër të P. H.; (ix) depozitim në llogari (transferte bankare), datë 17.12.2021, në shumën 1.500.000 lekë, për shlyerje të huas, datë 02.07.2010, në emër të P. H.; (x) certifikatë vdekjeje, datë 29.03.2016; (xi) vërtetim dhe verifikim i dokumentacionit me postë elektronike të ardhur në adresën email-it: {***}, nga dërguesi {***}, datë 03.03.2023; (xii) deklaratë personale me shkrim dore nga P. H., i nënshkruar më datë 02.02.2023.

⁵² *CPS Historical Poverty Footnotes.*

21.14. Lidhur me shkakun e ankimit se, *për shumën 5.000.000 lekë, të marrë hua nga ana e subjektit, u paraqitën një sërë dokumentesh, të cilët nuk u konsideruan të mjaftueshme nga Komisioni për të vërtetuar mundësinë financiare të huadhënësit P. H.*, trupi gjykues, në analizë të vendimit objekt ankimi, konstaton se Komisioni ka analizuar dhe vlerësuar dokumentacionin e disponuar dhe shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e depozituara në seancën dëgjimore të zhvilluar me subjektin e rivlerësimit, dhe ka konkluduar lidhur me to⁵³. Trupi gjykues, në përgjigje të pretendimeve të subjektit në ankim dhe parashtrime, analizoi dokumentacionin në dosjen gjyqësore të Komisionit dhe kreu vlerësimin për çdo shkak ankimor, për sa trajtuar në vijim.

21.15. Sa i përket pretendimit se, *duke ballafaquar provat e paraqitura nga subjekti me vetë praktikën e Kolegjit në vendimin nr. 2/2023 (JR)*⁵⁴, konkluzionet e Komisionit më sipër nuk qëndrojnë, pasi, në rastin konkret, rezulton që huadhënësi ka pasur aktivitete të shtrira në kohë, të cilat nuk deklaroheshin në një format të detajuar në vitet 1991–1998. Të kërkuar nga subjekti të provohet i gjithë aktiviteti i huadhënësit, që nga viti 1984 deri në dhënien e huas, duke ia ngarkuar asaj barrën e provës edhe për këto vite, periudhë e largët për të cilën nuk parashikohej detyrimi për deklarim, është jo proporcionale, me konsideratë qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij, një pretendim i tillë nuk mund të përbëjë *apriori* shkak për të pretenduar vlerësim të ndryshëm të fakteve në vendimin e dhënë nga Komisioni për subjektin, në raport me atë të mbajtur nga Kolegji ndaj subjekteve të tjera të rivlerësimit. Përpos sa më sipër, trupi gjykues sjell në vëmendje se specifika e procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 e 32 të ligjit nr. 84/2016, është që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë detyrimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë të krijuar nga huamarrje, të konfirmuara dhe nga personat e tjerë të lidhur. Në këtë rast, barra e provës zhvendoset te subjekti i rivlerësimit, pra i përket këtij të fundit detyrimi për të provuar pretendimet e tij lidhur me marrëdhëniet e huas, duke paraqitur prova e fakte të nevojshme për këtë qëllim.

21.15.1. Për më tepër, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore lidhur me burimet e pretenduara të të ardhurave të huadhënësit për krijimin e shumës së dhënë hua, *të ardhurat nga aktiviteti dhe ato nga qiradhënia*, trupit gjykues i rezulton që provohet regjistrimi i personit fizik

⁵³ Referohuni në paragrafët 1.139 – 1.146 të vendimit objekt shqyrtimi.

⁵⁴ 18.7 - [...], Kolegji vëren se, edhe në rastin e analizës, për këtë person tjetër të lidhur, rezultojnë disa të ardhura të dokumentuara të krijuara prej tij dhe familjes së tij, por edhe një sërë të ardhurash të tjetra të pretenduara që vijnë si nga administrimi i ish-pronave të kthyera babait të tij e bashkëpronarëve, ashtu edhe nga aktiviteti tregtar që ky person ka zhvilluar në vite si aksionar në disa shoqëri, kuotat e të cilave i ka shitur më pas. **Ky aktivitet ka zgjatur në kohë dhe kjo situatë komplekse financiare, nëse do t'i nënshtrohej verifikimit e kontrollit me të njëjtën metodologji, sikurse të ardhurat e dhëna hua, do të rëndonte në mënyrë disproporcionale subjektin e rivlerësimit, i cili do të duhej të mbante një barrë prove të rëndë e të padrejtë për llogari të procesit të saj të rivlerësimit. [...].**

18.21 - Kolegji, pasi vlerësoi këtë rezultat financiar, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke pasur në konsideratë një sërë faktorësh që shoqërojnë situatën e personit tjetër të lidhur, si: (i) ekzistencën e disa burimeve që kanë mundësuar krijimin e të ardhurave në vite, të cilat janë deklaruar sipas vlerësimit të vetë personit tjetër të lidhur; (ii) të drejtat pasurore mbi pasuri të paluajtshme, të cilat duket se kanë prodhuar të ardhura ndër vite; (iii) shumat monetare të depozituara në llogari bankare në vlera më të mëdha se ato të dhëna hua, kohë para kryerjes së këtij transaksioni; (iv) pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për të provuar saktësisht normën e fitimit të personit tjetër të lidhur, në kushtet e llojit të veprimtarisë që ai kryente; (v) gabime të mundshme në përlllogaritje, duke qenë se personat, pasuria e të cilave është marrë në analizë, nuk kanë qenë ndonjëherë mbartës të ndonjë detyrimi për deklarim, si edhe në mungesë të ndonjë indicie që e bënte të pabesueshme ekzistencën e marrëdhënies së huas, arriti në konkluzionin se, në vlerësimin e përgjithshëm të gjithë këtyre rrethanave, balanca negative e konstatuar nuk do të konsiderohet si përcaktuese për provueshmërinë e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 45.000 eurosh dhe ajo do të konsiderohet se e kalon testin e parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

“P. H.”, me vendim nr. {***} regj., datë 06.01.1993, të Gjykatës së Rrethit Krujë, me objekt veprimtarie: *fotograf dhe tregtim i mallrave ushqimorë dhe industrialë etj.*, dhe vend ushtrimi aktiviteti, Fushë - Krujë, por nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen me kod fiskal {***}, të këtij tatimpaguesi, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës konfirmon se nuk ka të dhëna mbi: (i) të ardhurat e tatueshme të deklaruara për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, përfshirë të ardhurat e deklaruara/vlerësuara nga qiradhënia deri në vitin 2010;⁵⁵ (ii) të dhëna financiare, përfshirë qarkullimin e deklaruar/realizuar, fitim, sigurime shoqërore, kontrata qiraje etj., për të. Për burimin e tretë të pretenduar, *të dhënat bankare të huadhënësit*, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit në dosjen gjyqësore të Komisionit, vlerëson se huadhënësi rezulton me gjendje likuiditetesh në llogarinë bankare të huadhënësit në Raiffeisen Bank ShA, por ka qenë i pamundur përdorimi i tyre për dhënien e huas më datë 02.07.2010, pasi ato kanë qenë të investuara në depozitë, e cila maturohej më datë 21.06.2011 dhe nuk janë tërhequr para apo në datën e dhënies së huas. E njëjta situatë konstatohet edhe në llogarinë e huadhënësit pranë Credins Bank ShA.

21.15.2. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se huadhënësi ka pasur në dispozicion edhe të ardhurat e depozituara nga bashkëshortja e tij në dy llogari, në emër të nipërve të saj, S. dhe A. S.*, në vlerësimin e trupit gjykues, kjo rrethanë mbeti në nivel deklarativ, pasi *së pari* këto të ardhura u pretenduan nga subjekti i rivlerësimit në një fazë të avancuar të hetimit administrativ dhe duket si përpjekje e subjektit për të shtuar mundësinë financiare të huadhënësve për të dhënë huan në shumën e deklaruar. *Së dyti*, deklaratat noteriale të paraqitura nga subjekti në Komision janë krijuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe, si të tilla, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, merren me rezervë në këtë proces.

21.15.3. Në konkluzion, trupi gjykues, sikurse edhe Komisioni në vendim, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mundësinë financiare të huadhënësit P. H. për të dhënë hua shumën 5.000.000 lekë, personit të lidhur me subjektin, më datë 02.07.2010.

21.16. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se: *[...] bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, detyrimin për të paguar tatimin në burim e kishin qiramarrësit, të cilët ushtronin aktivitetin në premisat në pronësi të huadhënësit. Bazuar në legjislacionin e kohës, biznesi i vogël nuk dorëzonte raporte financiare në tatime. Vetëm me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 32, datë 31.12.2013, të miratuar në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, u bë i detyrueshëm dorëzimi i bilanceve të thjeshtuara për këto kategori aktivitetesh. Duhet theksuar se aktiviteti i fundit që ka kryer huadhënësi është në vitin 2006, pra ky detyrim nuk shtrihej për të [...], trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë nga organet tatimore nuk u konfirmua realizimi i të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti privat dhe nga marrëdhënia e qirasë, trupi gjykues e vlerëson pa relevancë trajtimin në vijim të këtyre shkaqeve ankimore mbi përkatësinë e detyrimit ligjor për shlyerjen e detyrimeve tatimore apo dorëzimin e bilanceve të thjeshtuara.*

⁵⁵ Subjekti i rivlerësimit ka depozituar me deklaratën e pasurisë vetting dhe me përgjigjet e pyetjes nr. 2, tri kontrata qiraje. Nga analizimi i tyre rezultoi që totali i të ardhurave të përfituara nga dy marrëveshjet e para të ketë qenë në shumën 900.000 lekë, pasi të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e dy ambienteve me sipërfaqe 86 m², më datë 10.12.2011, nuk mund të kenë shërbyer për dhënien e huas 5.000.000 lekë, në datën 02.07.2010. Këto të ardhura kanë qenë ndjeshëm larg të qenët të mjaftueshme për krijimin e shumës 5.000.000 lekë, të dhënë hua nga P. H., në kushtet që nuk u provuan me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e pretenduara nga dy burimet e tjera.

21.17. Sa i përket pretendimit të subjektit se [...] lëvizjet e shumave në llogaritë bankare plotësojnë një nga kriteret që ka përcaktuar Kolegji në jurisprudencën e tij, që tregon për një aktivitet të ligjshëm të huadhënësit, për më tepër, të realizuar në emigracion. Nga ana tjetër, vetë Komisioni ka pranuar që ka pasur lëvizje të konsiderueshme në bankë dhe shumat e depozituara tejkalojnë shumën e dhënë hua, e duke qenë ky një kriter vlerësimi, është e pakuptimtë përse nuk u morën në konsideratë. Legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave i detyronte bankat që të raportonin çdo lëvizje shumë mbi 1.5 milionë lekë. Në këtë aspekt, nuk ka pasur asnjë lloj kontrolli, pra këto para asnjëherë nuk kanë qenë të dyshimta [...], trupi gjykues, sikurse arsyetuar edhe më lart në këtë vendim, vlerëson se gjendja e likuiditeteve në bankë nuk mund të përbëjë një kriter vlerësimi në drejtim të provueshmërisë së kërkesave ligjore të përcaktuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Me konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se të ardhura të ligjshme nga emigracioni janë ato të ardhura të cilat provohen me dokumentacion justifikues ligjor dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet tatimore në vendin e origjinës së krijimit të tyre. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë depozituar në Komision, dokumentacion provues ligjor lidhur me këto të ardhura, të cilat kanë rezultuar të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës në shtetin e origjinës dhe aq më pak për të dhënë hua në shumën e pretenduar.

21.18. Subjekti i rivlerësimit, duke referuar qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”,⁵⁶ pretendon se, në këtë rast, diskutohen të ardhurat e krijuara në emigracion nga ana e huadhënësit, për periudha para procesit të rivlerësimit kalimtar, por qartazi standardi i ndjekur nga Komisioni, nuk është proporcional në këtë rast. Trupi gjykues vlerëson se rrethanat faktike dhe situatat ligjore, të sjella në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, për të ardhurat e krijuara në emigracion nga ana e huadhënësit, janë të ndryshme nga ato të rastit të sjellë në vëmendje, pasi subjekti i rivlerësimit arriti të dokumentojë realizimin e të ardhurave të huadhënësit nga punësimi në emigracion, por sikurse arsyetuar më lart në këtë vendim, nga verifikimi i kryer, ato rezultuan të pamjaftueshme për dhënien e huas në shumën e pretenduar. Për këtë arsye, trupi gjykues e gjen të pabazuar këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit.

21.19. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për lidhjen e kontratave të huas në kushtet e lirisë kontraktuale dhe të mirëbesimit mes palëve, marrëdhënien e afërt me huadhënësin, kujdesin e treguar ndaj konfliktit të interesit dhe fakti që këta persona janë korrektë dhe pa konflikte me ligjin, të ngritura për të tria marrëdhëniet e huas, trupi gjykues vlerëson se këto rrethana mund të vlerësohen në drejtim të etikës dhe angazhimit të vlerave profesionale të subjektit të rivlerësimit, por janë pa ndikim në drejtim të përmbushjes së detyrimit ligjor të përcaktuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar që huadhënësit kanë pasur mundësi financiare për dhënien hua të shumave të deklaruara.

21.20. Në përfundim, lidhur me pagesën e këstit të tretë, në shumën 30.000 euro, në datën 02.07.2010, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provuan mundësinë financiare të huadhënësit P. H. për dhënien e huas në shumën 5.000.000 lekë, në korrik të vitit 2010, duke rezultuar kështu me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për likuidimin e këtij kësti, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pagesën e këstit të fundit, në shumën 25.391 euro, në datën 30.06.2011

22. Për pagesën e këstit të fundit të çmimit të apartamentit dhe garazhit, në rrugën “{***}”, Tiranë, me burim të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, huan në shumën 15.000 euro, të marrë nga P. SH.,

⁵⁶ Paragrafët 88 - 93 të këtij vendimi.

me kontratë huaje nr. {***}, datë 01.03.2011, Komisioni në vendim ka arritur në konkluzionin se: *subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të barrës së provës në rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit P. Sh., për shumën 15.000 euro, dhënë hua bashkëshortit të subjektit me kontratë huaje datë 01.03.2011 [...], shumë e cila është deklaruar se është përdorur për pagesën e kështit të fundit, në shumën 25.391 euro, për blerjen e pasurisë “apartament” + “garazh”.*

22.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet më sipër të Komisionit, duke ngritur këto pretendime: **(i)** Nga ana e saj janë vënë në dispozicion të Komisionit, me përgjigjet e pyetësorëve, aktet shkresore që provojnë mundësinë financiare të huadhënësit për të dhënë hua shumën 15.000 euro, nga kursimet e tij, depozitat apo të ardhurat nga emigracioni, si nga vajza, ashtu edhe nga kunata, sipas kontratës së huas nr. {***}, datë 01.03.2011. **(ii)** Shtetasi P. SH. dhe familja e tij kanë pasur burime për krijimin e të ardhurave, për të cilat ka paraqitur edhe prova shtesë, konkretisht, dokumente shkresore, të cilat nuk janë paraqitur më parë për të dhe pjesëtarë të tjerë të familjes së tij, të gjeneruara nga puna e tyre 38 – 40-vjeçare, pensioni i pleqërisë dhe i invaliditetit të bashkëshortes, por edhe të ardhura nga emigracioni prej vajzës violiniste, e cila jeton e punon prej shumë vitesh në Australi, dhe kunata violiniste në Greqi, ndërkohë që huadhënësi nuk ka pasur shpenzime për banim, pasi kanë përfituar nga ligji “Për privatizimin e pronës shtetërore”, apartament banimi në Tiranë. **(iii)** Mundësinë për kursimin e të ardhurave të huadhënësit, subjekti e provon: (a) nga llogaritë bankare në ProCredit Bank, në monedhën *lekë* në vitin 2007, *euro* në vitin 2008 dhe *dollarë amerikanë* në vitin 2009; (b) si dhe fakti që në kohën e dhënies së huas, në mars 2011, huadhënësi ka blerë pasurinë e paluajtshme në rrugën “{***}”, Tiranë, në vlerën 70.000 euro, me kontratë shitje nr. {***} rep./kol., datë 11.05.2015, të lidhur pas kontratës së huas.

22.2. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, në përgjigje të shkaqeve ankimore më sipër, konstaton dhe vlerëson se:

22.2.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, si një nga burimet e krijimit të pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 105.13 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 24.41 m,²” në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] edhe huat e marra ndaj personave të tretë, përkatësisht me kontratën e datës 01.03.2011 [...]”. Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, të kësaj deklarate, subjekti deklaron: “Marrëdhënie huaje me shtetasin P. S. SH. (huadhënës). Burimi i huas: (i) *kursime nga puna*: (ii) *depozita në ProCredit Bank*.

Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, personi i lidhur me subjektin deklaron: *Kontratë huaje, datë 01.03.2011, marrë hua me qëllim shlyerjen e detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes, në shumën 15.000 euro, pa afat, likuiduar në dy këste shuma 10.000 euro, më datë 23.12.2013, dhe kësti i dytë në vlerën 5.000 euro, më datë 30.06.2014. Aktualisht shlyer tërësisht detyrimi. Konfirmuar përmbushja e detyrimit me deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 23.01.2017. Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur këto akte:*

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 23.01.2017, në të cilën P. SH. deklaron se ai, nga kursimet e tij në vite, si dhe nga depozita në ProCredit Bank ShA, i ka dhënë huamarrësit M. shumën 15.000 euro, pa afat kohor, por me interes depozite që aplikonte Raiffeisen Bank ShA. Shuma e dhënë hua më është kthyer nga huamarrësi në dy këste, konkretisht, kësti i parë në shumën 10.000 euro, është kthyer më datë 23.12.2013, kësti i dytë, në shumën 5.000 euro, është kthyer më datë 30.06.2014. Ndërsa në lidhje me interesat, kam hequr dorë vullnetarisht duke mos i kërkuar ato, për shkak të lidhjeve miqësore që kam me huamarrësin [...].

- Kontratë huaje datë 01.03.2011, lidhur pranë avokat F. DH., Dhoma Avokatisë Lezhë, sipas të cilës huadhënësi P. SH., i jep bashkëshortit të subjektit hua shumë prej 15.000 euro, *pa afat të caktuar, me interesin e depozitës që aplikon Raiffeisen Bank ShA. Në kontratë parashikohet, shuma e interesit në % do të llogaritet në shlyerjen përfundimtare të kështit të fundit, e cila do të jetë në varësi të aftësisë likuiduese të huamarrësit.*

- Deklaratë e thjeshtë, e datës 23.12.2013, në të cilën huadhënësi P. SH. deklaroi se *nga huamarrësi L. M. i është shlyer pjesërisht shuma 10.000 euro, sipas kontratës së datës 01.03.2013.*

- Deklaratë e thjeshtë, e datës 30.06.2014, e huadhënësit P. SH., në të cilën deklaroi se *nga huamarrësi L. M. i është shlyer shuma e mbetur prej 5.000 euro, sipas kontratës së datës 01.03.2011. Përfundimisht detyrimet kontraktore janë shlyer totalisht.*

22.2.2. Në deklaratën periodike vjetore 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, *shlyer kështi i fundit i blerjes së apartamentit më datë 30.06.2011, në shumën 25.391 euro, te firma “{***}” ShPK, pa deklaruar burim të të ardhurave për këtë pagesë. Në po këtë deklaratë, personi i lidhur me subjektin, deklaroi: kontratë huaje datë 01.03.2011, kredidhënës P. SH. gjendja e detyrimit “15.000 euro”.*

22.2.3. Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se më datë 07.01.2011, është shlyer nëpërmjet bankës Intesa Sanpaolo ShA shuma 13.000 euro, ndërsa shuma prej 12.391 euro, është shlyer *cash* në arkën e shoqërisë duke depozituar edhe mandat pagesën nr. {***}, datë 30.06.2011 të shoqërisë “{***}” ShPK.

22.2.4. Si burim krijimi të shumës së dhënë hua, në përgjigje të të njëjtit pyetësor, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) *kursime nga puna e huadhënësit në “{***}” ShPK, dhe (ii) depozita e tij në ProCredit Bank ShA.* Për sa sipër, subjekti ka depozituar në Komision këto akte: (i) kopje kontrate depozite bankare, e datës 19.03.2015, në Bankën Kombëtare Tregtare ShA, për derdhjen nga P. SH. të depozitës 8.000 euro, më datë 20.03.2015, me afat maturimi 1 (një) vit dhe interes 0.5% në vit; (ii) kërkesë nr. {***}, datë 12.05.2015, për regjistrimin e kontratës së shitjes dhe lëshimin e certifikatës së pronësisë, blerës P. SH.; (iii) mandat bankar, nga Credins Bank ShA, për pagesën e tatimit për kalim prone, datë 12.05.2015; si dhe (iv) mandat pagese për lëshimin e certifikatës së pronësisë të datës 12.05.2015. Komisioni ka arsyetuar se dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit nuk arrin të dokumentojë burimin e të ardhurave të këtij huadhënësi për huan e dhënë në vitin 2011, pasi i përket një periudhe kohore pas dhënies së saj.

22.2.5. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës ka informuar, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.09.2022, se P. SH. ka qenë i punësuar si nëpunës te shoqëria “{***}” ShPK, me NIPT {***} dhe ka dërguar të dhëna në lidhje me pagën, mbi të cilën është derdhur kontribut për periudhën 2012 – 2016. Për vitin 2012 janë deklaruar të ardhura në vlerën 560.000 lekë. Sa i përket periudhës deri në vitin 2011, kjo Drejtori ka konfirmuar se shoqëria i ka derdhur kontributet te Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë. Drejtoria Qendrore e Arkivit Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.11.2022, vërteton se paga mbi të cilën janë paguar kontributet për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011, rezulton në shumën 360.000 lekë.

22.2.6. Nisur nga fakti që në deklaratën periodike vjetore 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndryshim të pasurive (shtesa/pakësime), ndryshim të gjendjes së likuiditeteve në *cash*, dhe në sqarimet e dhëna “lidhur me deklarimin e pasurisë 2003 – 2013”, pranë ILDKPKI-së⁵⁷, deklaroi ndër

⁵⁷ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 03.08.2022, të ILDKPKI-së.

të tjera: “[...], viti 2011, nuk rezultojnë lekë cash [...]”, Komisioni ka vlerësuar që duket se burimi i deklaruar nga subjekti (kontratë huaje, datë 01.03.2011), për pagesën e shumës 25.391 euro, deri në datën 30.06.2011, ka qenë i pamjaftueshëm. Në këto kushte, Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare paraprake huan në shumën 15.000 euro, të pretenduar në mars të vitit 2011, dhe pagesat në cash për shlyerjen e saj, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojnë ligjërisht burimin e krijimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, huadhënësit P. SH.

22.2.7. Në shpjegimet për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit paraqiti prova të tjera shtesë⁵⁸ për të provuar se huadhënësi P. SH. dhe familja e tij kanë pasur burime të ardhurash, të gjeneruara nga puna e tij prej 38 – 40 vitesh, nga pensioni i pleqërisë dhe ai i invaliditetit,⁵⁹ pretendoi të ardhura të siguruara nga vajzat në emigracion, si dhe faktin se nuk kanë pasur shpenzime, pasi banojnë në banesën e përfutur nga privatizimi, në Tiranë. Subjekti ka pretenduar se huadhënësi ka pasur mundësi kursimi për të dhënë huan, e provuar kjo me llogaritë bankare në ProCredit Bank ShA⁶⁰. Po ashtu, si argument shtesë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se huadhënësi ka pasur të ardhura të mjaftueshme, pasi në kohën e dhënies së huas, më datë 01.03.2011, nga ana e tij është kryer blerje pasurie e paluajtshme, më datë 11.05.2015, në vlerën 70.000 euro⁶¹.

22.2.8. Në analizë të shpjegimeve dhe të akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar se, në bazë të dokumentacionit të administruar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për P. SH., për periudhën janar 2006 – shkurt 2011, të ardhurat e dokumentuara janë në shumën 1.374.588 lekë dhe shpenzimet për jetesë vetëm për huadhënësin, për këtë periudhë, sipas të dhënave nga INSTAT-i, rezultojnë në shumën 665.257 lekë. Pra, mundësia për kursim e tij duket se është 709.331 lekë, rreth 5.100 euro, pa përfshirë këtu të ardhura të tjera, shpenzime shtesë dhe krijim pasurie, shumë kjo disa herë më e vogël se huaja e dhënë. Për sa i përket pretendimeve të subjektit lidhur me burimet e tjera të të ardhurave dhe mundësitë financiare të personit të lidhur si huadhënës, ato mbeten në kuadrin deklarativ.

22.2.9. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit P. SH., për të dhënë hua shumën 15.000 euro bashkëshortit të subjektit, më datë 01.03.2011, shumë të cilën e ka deklaruar si burim për pagesën e këstit të fundit për blerjen e pasurive “apartament” dhe “garazh”, në rrugën “{***}”, Tiranë.

⁵⁸ Provat shtesë konsistojnë në: (i) dosjen e plotë të praktikës së përfutimit të pensionit të pleqërisë së huadhënësit me vendimin nr. {***}, datë 28.01.2016, në të cilën janë dokumente ligjore, që provohet periudha e punësimit prej 38 vite e 2 muaj, në detyrat dhe funksionet përkatëse, si dhe pagat respektive për të gjithë periudhën e vlerësuar nga DRSSH-ja, si periudhë sigurimi; (ii) librezë pensioni nr. {***}, datë 01.11.2015; (iii) librezë pensioni nr. {***}, në emrin e personit të lidhur të huadhënësit, L. SH.; (iv) nxjerrje llogarie të ProCredit Bank ShA, me nr. {***}, në monedhën lekë, për periudhën 27.12.2007 – 19.07.2016; (v) nxjerrje llogarie të ProCredit Bank ShA, me nr. {***}, në monedhën euro, për periudhën 22.01.2008 – 17.01.2014, (vi) nxjerrje llogarie të ProCredit Bank ShA, me nr. {***}, në USD, për periudhën 12.01.2009 – 14.01.2013; (vii) kontratë shitje pasuri e paluajtshme e llojit “njësi”, të ndodhur në Tiranë, në rrugën “{***}”, me nr. pasurie {***}, NT. {***} rep./kol., datë 11.05.2015, mes palës shitëse P. dhe R. M., dhe palës blerëse P. SH., kundrejt çmimit 70.000 euro, (viii) kopje mandati depozitimi në arkë/cash deposit, në Alpha Bank ShA, më datë 11.05.2015, të shumës 70.000 euro, nga P. SH. (blerësi), në llogari të noteres DH. Q.

⁵⁹ Subjekti ka paraqitur dosjen e plotë të praktikës së përfutimit të pensionit të pleqërisë me vendimin nr. {***}, datë 28.01.2016, librezë pensioni nr. {***}, datë 01.11.2015, librezë pensioni nr. {***}, në emrin e L. H. SH. (bashkëshortja).

⁶⁰ Subjekti ka paraqitur nxjerrje llogarie në ProCredit Bank ShA, në monedhën lekë, për periudhën 27.12.2007 – 19.07.2016, në monedhën euro, për periudhën 22.01.2008 – 17.01.2014, dhe në monedhën USD, për periudhën 12.01.2009 – 14.01.2013.

⁶¹ Subjekti ka paraqitur kontratë shitje pasuri e paluajtshme, të pasurisë me çmim 70.000 euro, në datën 11.05.2015.

22.3. Trupi gjykues, në përgjigje të shkaqeve të ankimit më sipër dhe në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore për këtë hua, vlerëson se:

22.4. Lidhur me pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit se, *nga ana e saj janë vënë në dispozicion të Komisionit, me përgjigjet e pyetësorëve, aktet shkresore që provojnë mundësinë financiare të huadhënësit për të dhënë hua shumë 15.000 euro, nga kursimet e tij, depozitat apo të ardhurat nga emigracioni, sipas kontratës së huas nr. {***}, datë 01.03.2011*, trupi gjykues çmon se nuk rezulton i provuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se burimi i huas kanë qenë: (i) të ardhurat nga kursimet e huadhënësit; (ii) depozitat apo (iii) të ardhurat nga emigracioni, pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit jep informacion vetëm për të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë. Konkretisht, referuar *vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare*, me nr. {***} prot., datë 07.11.2022, të përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 09.11.2022, të ISSh-së, Drejtoria e Arkivit Qendror Tiranë, rezulton që huadhënësi, për periudhën janar 2011 – dhjetor 2011, të ketë përfituar të ardhura nga subjekti “{***}” ShPK, në shumë 360.000 lekë në total. Evidentohet qartë që kjo shumë është ndjeshëm larg të qenët e mjaftueshme për të justifikuar dhënien hua të shumës 15.000 euro, në vitin 2011. Po kështu, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, për të siguruarin P. SH., për periudhën janar 2006 – shkurt 2011, paraqitur në Komision nga subjekti i rivlerësimit me shpjegimet për rezultatet e hetimit, rezulton që huadhënësi ka përfituar të ardhura për këtë periudhë në shumë 1.374.588 lekë, të pamjaftueshme këto për të mbuluar shpenzime jetike dhe krijuar kursime në masën e shumës së dhënë hua. Referuar kopjes së kontratës së depozitës bankare, të datës 19.03.2015, në Bankën Kombëtare Tregtare ShA, të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, për derdhjen e shumës 8.000 euro, më datë 20.03.2015, dhe investimin e saj në depozitë me afat maturimi 1 (një) vit, trupi gjykues çmon se ky akt nuk provon ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të huadhënësit për dhënien e huas në vitin 2011, por thjesht dëshmon për gjendje likuiditeti të tij në bankë, në vitin 2015. Lidhur me lëvizjet e llogarive bankare të huadhënësit në ProCredit Bank ShA, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me rezultatet e hetimit, trupi gjykues konstaton se huadhënësi ose ka tërhequr shuma të vogla kohë përpara datës së dhënies së huas, në mars të vitit 2011, ose rezulton që të ketë pasur likuiditete të investuara në depozita me afat, të rinovuara periodikisht, gjendje në bankë.

22.5. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se huadhënësi dhe familja e tij kanë pasur burime për krijimin e të ardhurave, për të cilat ka paraqitur edhe prova shtesë, konkretisht, dokumente shkresore, të cilat nuk janë paraqitur më parë për të dhe pjesëtarë të tjerë të familjes së tij, L. SH., kanë gjeneruar të ardhura nga puna e tyre 38 – 40-vjeçare, pensioni i pleqërisë dhe i invaliditetit të bashkëshortes, por edhe të ardhura nga emigracioni prej vajzës violiniste, e cila jeton e punon prej shumë vitesh në Australi, dhe kunata violiniste në Greqi, ndërkohë që huadhënësi nuk ka pasur shpenzime për banim, pasi kanë përfituar nga ligji “Për privatizimin e pronës shtetërore”, apartament banimi në Tiranë*, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit dhe të vendimit të Komisionit, konstaton se aktet e pretenduara të sjella shtesë nga subjekti i rivlerësimit janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe janë trajtuar në vendim në vlerësimin e Komisionit lidhur me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit.⁶² Të ardhurat e pretenduara nga emigracioni prej vajzës violiniste në Australi dhe kunata violiniste në Greqi, trupi gjykues vlerëson se ato mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion justifikues.

⁶² Referohuni në paragrafët 1.162 e vijues të vendimit të Komisionit.

22.6. Për pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se huadhënësi ka pasur mundësi për kursimin e të ardhurave në kohën e dhënies së huas, pasi ai ka blerë pasurinë e paluajtshme në rrugën “{***}”, Tiranë, në vlerën 70.000 euro, me kontratë shitje nr. {***} rep./kol., datë 11.05.2015, të lidhur pas kontratës së huas, trupi gjykues vlerëson se transaksioni për blerjen e kësaj pasurie daton larg kohës së dhënies së huas dhe nuk mund të shërbejë, për efekt të këtij procesi, si kriter vlerësimi në drejtim të provueshmërisë së huadhënësit për të dhënë huan 15.000 euro, në mars të vitit 2011.

22.7. Lidhur me pagesën e kështit të fundit në shumën 25.391 euro, në datën 30.06.2011, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provuan mundësinë financiare të huadhënësit P. SH. për dhënien e huas në shumën 15.000 euro, në mars të vitit 2011, duke rezultuar kështu me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për likuidimin e këtij kësti, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

22.8. Në përfundim, për pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 105 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 24.41 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me analizën financiare për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016

23. Komisioni, në vendim lidhur me analizën financiare, ka konkluduar:

(i) Për sa i përket raportit financiar të depozituar, nga Komisioni konstatohet se ai ka marrë në shqyrtim si vit bazë vitin 2002, por pa analizuar dokumentacionin provues për vlerat monetare në bankë dhe cash në datën 31.12.2002. Nisur nga fakti që deklarimi fillestar është kryer në vitin 2003, duket i paqartë dokumentacioni në të cilin është mbështetur kontabilisti i autorizuar për të vlerësuar gjendjen e likuiditeteve cash në datën 31.12.2002. Analiza në vitet në vazhdim nuk është bazuar në deklaratimet e subjektit për gjendjet cash të deklaruara, shtesa/të pakësuara, por në fillim të vitit është aplikuar diferenca e llogaritur midis të ardhurave (hyrjeve të fondeve) dhe shpenzimeve/blerje të pasurive (daljeve të fondeve).

(ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e barrës së provës në lidhje me balancat negative të konstatuara nga analiza e përgjithshme paraprake e treguesve financiarë, të kryer nga Komisioni, për periudhën 2003 – 31.12.2016, nga e cila, për vitet e mbyllura 2004, 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të deklaruara/dokumentuara, për blerje/krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këto vite, përkatësisht në shumat (-) 498.444 lekë, (-) 1.774 lekë, (-) 419.840 lekë, (-) 997.996 lekë, (-) 5.656.597 lekë dhe (-) 1.229.287 lekë.

23.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim dhe parashtrime konkluzionet më sipër të Komisionit me pretendimet se Raporti Financiar (hartuar nga kontabilisti i miratuar) mbështetet në të njëjtat të dhëna të administruara nga Komisioni dhe nuk ka nevojë për dokumente të tjera, por nxjerr në pah gabimet e metodologjisë së ndjekur nga Komisioni.

23.2. Në analizë të pretendimeve më sipër të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues thekson se një pjesë e shkaqeve ankimore të natyrës financiare kanë marrë përgjigje më sipër në këtë vendim, në trajtimin e pasurisë “apartament banimi” dhe “garazh”, në rrugën “{***}”, Tiranë, konkretisht: (i) për kryerjen më vete të analizës financiare të vitit 2003, nga ajo e periudhës së mëparshme deri në fund

të vitit 2002; (ii) për mungesën e burimeve financiare të ligjshme të prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kursimeve në masën e pretenduar gjatë hetimit në Komision, për periudhën 1989 – 2002; (iii) për mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për shtesën e kursimeve në *cash*, në shumën 300.000 lekë, në fund të vitit 2004; (iv) lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash* dhe në bankë në fund të vitit 2006, 2007, për shkak të efektit të mbartjes së kursimeve të pretenduara nga prindërit e bashkëshortit nga viti 2002 deri në vitin 2007, për shkak të mbartjes së tepricave të periudhave të mëparshme në vitet pasardhëse, si dhe (v) pamundësia financiare e huadhënësve, për të dhënë hua shumat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, me pasojë mospërfshirjen si të huave, ashtu edhe shlyerjen e tyre në analizën financiare të viteve respektive.

23.3. Trupi gjykues, pasi kontrolloi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare të Komisionit, për periudhat 1989 – 2003 dhe 2004 – 2016, vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, që *raporti financiar mbi gjetjet e hetimit administrativ për vlerësimin e pasurisë dhe të mundësive financiare të subjektit të rivlerësimit*, hartuar nga kontabilisti i miratuar P. XH., *nxjerr në pah gabimet e metodologjisë së ndjekur nga Komisioni*, nuk qëndron, pasi, *së pari*, metodologjia e ndjekur nga Komisioni ka vlerësuar: (i) në mënyrë objektive saktësinë e deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, të cilat, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencën e Kolegjit, përbëjnë provë në këtë proces; (ii) ka vlerësuar dokumentacionin justifikues të administruar gjatë hetimit në Komision dhe atë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit; (iii) ka analizuar mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive në momentin e krijimit të tyre; (iv) mbulimin e shpenzimeve të jetesës sipas standardit të përcaktuar nga shkresa e ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, si dhe (v) vjen në linjë me logjikën e ligjit dhe metodologjinë e zbatuar në procesin e rivlerësimit, për kontrollin e kriterit të pasurisë. *Së dyti*, subjektit të rivlerësimit i është njoftuar rezultati i analizës financiare, i janë dhënë shpjegime të treguesve financiarë me aneksin bashkëlidhur rezultateve të hetimit administrativ, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të kuptojë metodologjinë e përdorur për hartimin e saj dhe ta kundërshtojë atë.

Për më tepër, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë nuk është ngushtësisht financiar, por ndërthurje mes interpretimit ligjor dhe analizës financiare, vlerësimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive dhe verifikimit të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur apo të tjerë të lidhur me të, mbështetur në legjislacionin e zbatueshëm në këtë proces, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

Sa i përket metodologjisë që kontabilisti i miratuar ka përdorur në hartimin e raportit financiar, të paraqitur në cilësinë e provës, nga subjekti i rivlerësimit, me prapësimet për rezultatet e hetimit, trupi gjykues vëren se ai nuk merr në konsideratë kuadrin ligjor të zbatueshëm në këtë proces, me efekt në rezultatet financiare, të cilat janë të ndryshme nga ato të Komisionit. Konkretisht, kontabilisti i miratuar anashkalon faktin që subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar me saktësi të gjitha të pasuritë e disponuara, si dhe burimet e krijimit të tyre në deklaratën e pasurisë 2003. Kontabilisti i miratuar, duke mbartur në analizën e kryer prej tij, balancat e viteve paraardhëse në ato pasuese, të padeklaruara në deklaratat periodike vjetore apo/dhe atë të pasurisë *vetting*, nuk merr në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, në nenin 4 të tij, duke ndjekur kështu një metodologji të zbatueshme për subjekte tregtare. Për gjithë sa më sipër argumentuar, trupi gjykues e vlerëson këtë pretendim të subjektit të pabazuar.

23.4. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, për periudhën 2003 – 2016, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues vlerëson se mbetet e konfirmuar mungesa e burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 8.803.938 lekë, vlerë e cila nuk mund t'i nënshtrohet parimit të proporcionalitetit të parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit. Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara gjatë kësaj periudhe, duke u ndodhur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

24. Në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 635, datë 13.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rexhina Merlika.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 10.04.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi